



VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR.8(410)

GUSHT 2022

ÇMIMI: 30 LEKË



Drejtor: MUHARREM GJOKA; Kryeredaktor: HALIL RAMA ; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI Email: veterani.obvl@yahoo.com / website: www.VETERANIOBVL.ORG

100-VJETORI

OBVL, MESAZH URIMI PËR PRESIDENTIN BEGAJ

OPINION



SHQIPËRI-SHBA, 100 VJET MIQËSI, PRESIDENTI BIDEN: ME JU, EDHE DREJT BE-SË

FAQE 3

“E ARDHMJA E VENDIT, PËRGJEGJËSI E TË GJITHËVE”



FAQE 4

SAMITI I MADRIDIT DHE SHQIPËRIA



NGA HALIL RAMA

FAQE 5

Historike - Shqipëria hapi më 19 korrik 2022 negociatat me Bashkimin Europian

RRUGËTIMI I SHQIPËRISË DREJT BASHKIMIT EUROPIAN

Mirëqenie, zhvillim e progres për qytetarët dhe vendin

BAJRAM BEGAJ

Dëshiroj të falënderoj Presidentin Meta, për përbushjen e detyrës, komunikimin institucional e personal që patëm gjatë kohës që unë, ushtrova detyrën e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura si dhe gjatë periudhës së transferimit të detyrës. Për mua sot është një ditë e veçantë, padyshim dita më e rëndësishme e jetës sime. Jam përpara jush dhe ju drejtohem me nderin dhe privilegjin më të madh të një individi, të zgjedhur në postin më të lartë të shtetit, atë të Presidentit të Republikës... **FAQE 4**



• Kapitulli i parë me të cilin do të nisë procesi i negociatave është ai i të drejtave themelore të njeriut dhe më pas do të ketë kapituj për reforma në drejtësi, lufta kundër korrupsionit, liria e medias etj **FAQE 2**

PËRKUJTIMORE

Ekzekutimet masive nga forcat serbe në Bosnjë Hercegovinë janë mizoria më e rëndë në Evropë pas Luftës së Dytë Botërore



Në Srebrenicë u përkujtuan viktimat e gjenocidit serb

NGA BASHKIM HISARI **FAQE 8**

STATUSI

79 vjet nga Masakra e Borovës, u jepet statusi “Dëshmor i Atdheut“ 107 civilëve të rënë

FAQE 3

HISTORIA

LUFTA E VLORËS

SIPAS ROMANIT

HISTORIK

“ULTIMATUM”

TE PETRO MARKOS

SAKIP CAMI

FAQE 6-7

LIBRI

“FJALORI ENCIKLOPEDIK USHTARAK SHQIPTAR” ARRITJE E MADHE NË KULTURËN KOMBËTARE

SHPENDI TOPALLAJ

FAQE 11

MONOGRAFIA

“BOTA E GUXIM-TARËVE - KAPEDAN ÇELO PICARI”

MAKSIM VINÇANI

FAQE 10

POEZI



Ali Pashë Tepelena në poezinë e Liljana Muçës

FAQE 12

NEGOCIATAT

Historike - Shqipëria hapi më 19 korrik 2022 negociatat me Bashkimin European

BE hap negociatat: Shqipëria të përmbushë reformat

16 vjet pas firmosjes së marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, Shqipëria hapi më 19 korrik 2022 negociatat me Bashkimin European. Fundi i fillimit drejt unionit që bëri realitet ëndrrën e kahershme të

shqiptarëve ndër shekuj.

Hapja e dyerve të unionit për Presidenten e Komisionit European, Ursula Von der Leyen është meritë e zbatimit të reformave dhe shtetit ligjor. “Keni treguar këmbëngulje, keni patur besim



- **Kapitulli i parë me të cilin do të nisë procesi i negociatave është ai i të drejtave themelore të njeriut dhe më pas do të ketë kapituj për reforma në drejtësi, lufta kundër korrupsionit, liria e medias etj**

tek procesi drejt BE-së, keni zbatuar shtetin ligjor, keni median e lirë, keni një shoqëri civile të gjallë dhe keni bërë shumë reforma dhe keni modernizuar ekonominë tuaj”. Për komisionerin Oliver Varhelyi ndezja e dritës jeshile për Shqipërinë është një ditë drejt rrugëtimit të saj evropian. “Është një ditë historike për BE dhe Shqipërinë. Durimi strategjik është shpërblyer, ju përgëzoj për këtë sukses të arritur. Shqipëria vijon të përmbushë të gjitha

kushtet, keni reformuar institucionet demokratike, sistemin gjyqësor, lufta kundër korrupsionit dhe krimin është për tu lavdëruar”.

Shefi i Politikës së Jashtme në Bashkimin European Josep Borelli e cilësoi një hap të rëndësishëm drejt plotësimit të BE-së, duke vlerësuar drejtimin “pro” evropian të Shqipërisë. Kryeministri Rama foli për një hapësirë të shtuar që tha se dikton të ardhmen e përbashkët të Ballkanit Perëndimor në union, teksa ju referua nismës së “Ballkanit të Hapur”. “BE ka nevojë për Ballkanin Perëndimor po aq sa Ballkani Perëndimor ka nevojë për Bashkimin Evropian. Tani e tutje nuk do të jenë vetëm 2, por 4 nga 6 shtetet e Ballkanit Perëndimor për të negociuar hyrjen e tyre në Bashkim”. Në konferencën e përbashkët për shtyp, Komisioneri për Zgjerimin ndonëse nuk foli për një afat për anëtarësimin e Shqipërisë në BE, u kujdes t'i tregonte Kryeministrit Rama detyrat që duhej të përmbushte Shqipëria.

Po atë ditë (19 korrik 2022 pasdite) Shqipëria nisi procesin screening dhe kjo do të lejojë vlerësimin e të gjitha çështjeve që do adresohen nga negociatat. Por sigurisht, sipas kryeministrit rama duhet konsensus mbarëkombëtar sepse në këtë rrugëtim duhen të tërë për t'i bërë këto negociata gjithëpërfshirëse e shteruese”. Kryereforma tha se është ajo në drejtësi, ku padyshim BE kërkon që t'i shkohet deri në fund ndjekjes penale të gjyqtarëve e prokurorëve që dolën jashtë sistemit pas procesit të Vettingut.

Eurokomisioneri Varhelyi: “Kapitulli i parë që do të hapet e do mbyllet është shteti ligjor dhe dukshëm gjendja e gjyqësorit do diskutohet, ju konfirmoj se ne s'do sprapsemi në kërkesat tona dhe duhet të ketë prova për rastet që duhen zgjidhur dhe ato duhen zgjidhur”.

Kryeministri Rama: “Kërkesa për të hapur procese dhe ndëshkuar gjykatës e prokurorë që janë përjashtuar nga Vettingu për pasuri marramendëse është kërkesë e kahershme e BE dhe është e natyrshme e BE që është në sinkron të plotë me popullin shqiptar që e mbështeti fuqimisht Reformën në Drejtësi”. Hapja e negociatave për Shqipërinë vjen 8 vite pas marrjes së statusit të vendit kandidat.

Rrugëtimi i Shqipërisë drejt Bashkimit European

Procesi i integritit i Shqipërisë në Bashkimin European (BE) është konsideruar si prioriteti më strategjik kombëtar, i cili udhëheq axhendën qeverisëse të vendit. Që nga qershori i viti 2014, Shqipëria gëzon statusin e vendit kandidat për në BE. Megjithatë kriteret e vendosura nga Bashkimi European për anëtarësim janë parakushte për kalimin e fazës tjetër të procesit, i cili është ai i hapjes së negociatave.



zave, duke lejuar qytetarët shqiptarë të udhëtojnë pa viza në Zonën Shengen.

Në 2009-tën, Shqipëria gjithashtu paraqiti kërkesën e saj zyrtare për antarësim në Bashkimin European. Komisioni Evropian paraqiti një Opinion (në vitin 2010), me kërkesën e Këshillit European në lidhje me aplikimin për anëtarësim, duke vlerësuar se Shqipëria kishte ende për të përmbushur 12 prioritetet kyçe, në mënyrë që të arrinte një shkallë të nevojshme të pajtueshmërisë me kriteret e anëtarësimit.

Në tetor të vitit 2012, Komisioni rekomandoi që Shqipërisë t'i jepej statusi i kandidatit të BE, në varësi të përfundimit të reformave, veçanërisht në fushat e reformës së gjyqësorit dhe administratës publike.

Në qershor të vitit 2014, Këshilli European i dha Shqipërisë statusin e kandidatit. Marrja e statusit të vendit kandidat shënon një hap shumë të rëndësishëm në procesin e integritit të Shqipërisë në BE, pasi reflekton ecurinë e reformave të ndërmarra dhe i hap rrugë procesit të

plotë të aderimit të vendit në BE.

Cfarë nënkupton hapja e negociatave me BE-në?

Hapja e negociatave do të thotë një proces teknik që do të nisë me kontrollin e plotë të administratës shtetërore shqiptare dhe të gjithë legjislacionit shqiptar që të përafrohet me legjislacionin e Bashkimit European.

Komisioni European do të nisë ekipet që do t'i bashkëngjiten administratës shtetërore në Shqipëri, ku do të kontrollojë ligjet dhe zbatimin e tyre.

Me përafrimin e këtyre ligjeve do të hapen dhe mbyllen kapituj me sukses ose dështim, që në total do të jenë 35.

Kapitulli i parë me të cilin do të nisë procesi i negociatave është ai i të drejtave themelore të njeriut dhe më pas do të ketë kapituj për reforma në drejtësi, lufta kundër korrupsionit, liria e medias etj.

Më pas do të ketë kapituj dhe për lidhjet ekonomike dhe tregtare. Ky proces do të ndiqet hap pas hapi nga Komisioni European. Ky proces pritet të zgjasë disa vite.

Bashkimi European mori zotimin për tu zgjeruar në Ballkanin Perëndimor në Samitin e Selanikut në Qershor të 2003-it, ku Shqipëria, së bashku me vendet e tjera të rajonit u identifikuan si vendet candidate potenciale për anëtarësim.

Në qershor të 2006-tës, Shqipëria nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim dhe Asociimit, e cila hyri në fuqi në prill të vitit 2009. Kjo marrëveshje zëvendësoi marrëveshjen e mëparshme me Komunitetin Ekonomik Evropian mbi tregtinë dhe bashkëpunimin ekonomik dhe atë tregtar, nënshkruar në maj të vitit 1992.

Objektivi i kësaj qasje të re politike të BE-së ndaj vendeve të Ballkanit Perëndimor lidhet me rritjen e stabilitetit rajonal dhe parapërgatitjen e vendeve të rajonit për t'u integruar në Bashkimin European.

Në dhjetor të vitit 2010, hyri në fuqi marrëveshja për heqjen e regjimit të vi-

100-VJETORI

Begaj: Mbështetja e Amerikës për vendin tonë është e paçmuar. Lidhjet mes dy vendeve do vazhdojnë të forcohen

Shqipëri-SHBA, 100 vjet miqësi, Presidenti Biden: Me ju, edhe drejt BE-së


Përmes një videomesazhi, Biden uroi shqiptarët, duke garantuar se vendi i tij do të qëndrojë krah Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit dhe forcimit të demokracisë

Një shekull marrëdhënie diplomatike Shqipëri-SHBA, vijnë me përkushtimin dhe premtimin e kreut të Shtëpisë së Bardhë Joe Biden se Amerika do të jetë krah shqiptarëve edhe në rrugën drejt integritit euro-pian.

100-vjetori i marrëdhënieve diplomatike mes dy vendeve bëri bashkë më 28 korrik 2022 në një ceremoni krerët më të lartë të shtetit, ish-Presidenti, si dhe deputetë të Kuvendit. Përmes një videomesazhi, Biden uroi shqiptarët, duke garantuar se vendi i tij do të qëndrojë krah Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit dhe forcimit të demokracisë.

Videomesazhi i kreut të Shtëpisë së Bardhë u publikua në eventin që u mbajt në Tiranë me rastin e 100-vjetorit të marrëdhënieve me SHBA-në. “Dërgoj urimet më të përzemërta për miqësinë jetëgjatë të SHBA-së, ndërsa festojmë 100-vjetorin e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike mes vendeve tona.

Kur SHBA-ja mbrojti pavarësinë e Shqipërisë pas Luftës së Parë Botërore, u krijua një miqësi e përherëshme e popujve tanë, një dashuri e përbashkët për lirinë dhe



vlerat e demokracisë, të cilat nuk u thyen kurrë edhe në dekadat e diktaturës. Në të ardhmen, SHBA-ja do të vazhdojë që të qëndrojë pranë Shqipërisë, ndërsa vendi forcon in-

stitucionet demokratike, lufton korrupsionin dhe përmbushni udhëtimin për t’iu bashkuar BE-së. Uroj që dy kombet të vazhdojnë të ndërtojnë gjithçka kemi arritur së

bashku dhe të ofrojmë një të ardhme më shpresëdhënëse për fëmijët tanë.

Sot, Shqipëria dhe SHBA-ja janë aleate në NATO dhe ne shikojmë në të ardhmen që SHBA-ja do të vazhdojë të bashkëpunojë me Shqipërinë për të ndjekur rrugën drejt BE-së”, tha Biden. Nuk mungoi as mesazhi i George W Bush, i pari President amerikan që vizitoi Shqipërinë në 10 qershor 2007. Urimin e tij e përcolli ambasadorja Juri Kim.

“Unë dhe Laura ju dërgojmë urimet më të ngrohta. Ky gur kilometrik është një dëshmi e miqësisë mes vendeve tona. Nuk e harrojmë kurrë mikpritjen dhe kohën e bukur që kaluam në vendin tuaj. Jam i lumtur të shoh marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe SHBA-së. Shqipëria është një forcë e së mirës në botë dhe SHBA-ja është krenare që iu quan aleate”, shprehet George W Bush.

Kurse Presidenti Bajram Begaj vlerësoi mbështetjen amerikane për çështjen kombëtare. Në takimim për 100-vjetorin e marrëdhënieve diplomatike, Begaj u shpreh se mbështetja e Amerikës për vendin tonë është e paçmuar dhe se lidhjet mes dy vendeve do vazhdojnë të forcohen.

“Falë mbështetjes bujare dhe pa asnjë rezervë të SHBA-së, shqiptarët sot janë një faktor me rëndësi gjeopolitike në Ballkan. Mbështetja e SHBA-së është e paçmuar për çështjen tonë kombëtare. Me të njëjtat principe dhe me të njëjtën vendosmëri me të cilën u mbështet Shqipëria 100 vjet më parë, u mbështet edhe Kosova për shpalljen e pavarësisë. Marrëdhëniet do vazhdojnë të forcohen edhe qindra mijëra vite të ardhshme.

79 vjet nga Masakra e Borovës, Ministria e Mbrojtjes u jep statusin “Dëshmor i Atdheut“ 107 civilëve të rënë

Në 79 - vjetorin e Masakrës së Borovës, Ministria e Mbrojtjes u akordoi statusin ‘Dëshmor i Atdheut’, 107 civilëve të rënë. Në aktivitetin e organizuar në Kolonjë më 7 korrik 2022 ishte i pranishëm vetë ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, i cili përkujtoi së bashku me familjarët këtë ngjarje

tronditëse të historisë së vendit tonë.

Kryetari i Bashkisë së Kolonjës, Erion Isai falënderoi ministrin e Mbrojtjes Niko Peleshi për firmosjen e këtij akti, që ka qenë një përpjekje disavjeçare, ndërsa u shpreh gatishmëria e plotë nga ana e pushtetit lokal dhe atij qendror për ristrukturimin e muzeut.

Më 6 Korrik 1943, formacionet partizane goditën forcat naziste tek Ura e Barmashit. Ushtria gjermane si hakmarrje dogji Borovën, ku brenda një dite u vranë dhe masakruan 107 civilë. Pas këtij aktiviteti, ministri Peleshi iu përgjigj interesit të medias për situatën e zjarreve në vend



SPECIALE

BEGAJ: E ardhmja e vendit është përgjegjësi e të gjithëve

Presidenti i ri i Republikës së Shqipërisë SHT Z. Bajram Begaj, i cili do të jetë në krye të shtetit për pesë vitet e ardhshme, ka mbajtur fjalimin e tij të parë para Presidencës, pasiditen e 24 korrikut 2022.

Teksa renditi objektivat e tij në marrjen e detyrës si President, Bajram Begaj tha se u betua për besnikëri ndaj Kushtetutës e ligjeve të vendit, për të respektuar të drejtat dhe liritë e shtetasve, për të mbrojtur Pavarësinë e Republikës së Shqipërisë dhe për t'i shërbyer interesit të përgjithshëm dhe përparimit të Popullit Shqiptar. Presidenti Begaj tha se do të jetë shërbëtori i popullit të tij dhe do të mbështesë rrugëtimin euro-atlantik për të gjithë shqiptarët e Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi, Luginës së Preshevës, e kudo ata ndodhen.

MIRËQENIE, ZHVILLIM E PROGRES PËR QYTETARËT DHE VENDIN*

(vijon nga fq. 1)

Sot u betova për besnikëri ndaj Kushtetutës e ligjeve të vendit, për të respektuar të drejtat dhe liritë e shtetasve, për të mbrojtur Pavarësinë e Republikës së Shqipërisë dhe për t'i shërbyer interesit të përgjithshëm dhe përparimit të Popullit Shqiptar. Do të jem shërbëtor i popullit tim, përfaqësues i unitetit tonë kombëtar, mbështetës i palëkundur i rrugëtimin euro-atlantik për të gjithë shqiptarët e Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi, Luginës së Preshevës, e kudo që ata jetojnë e punojnë. Do të jem kontribues dhe përkrahës i komunikimit e bashkëpunimit, i nismave dhe ideve që zhvillojnë e çojnë përpara shoqërinë tonë. Dialogu dhe bashkëpunimi, midis forcave politike, shoqërisë civile, komuniteteve fetare, të pakicave kombëtare, dëgjimi i vëmendshëm i zërit të medias së lirë, transparente dhe të vërtetë, respektimi dhe pranimi i debatit mundëson që forca e tij të mishërohet në mirëqenie, zhvillim e progres për qytetarët dhe vendin.

E ardhmja e vendit është përgjegjësi e të gjithëve. Interesi ynë i përbashkët mbetet konsolidimi i institucioneve, të cilat kanë përgjegjësinë, për të garantuar sigurinë e vendit; për të forcuar liritë e të drejtat

• **Të vijojmë në rrugën e reformës në drejtësi, jo thjesht sepse ky është një kusht thelbësor në procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian, por edhe sepse ndërtimi i një sistemi gjyqësor të pavarur, dhe me integritet, garanton luftë pa kompromis kundër korrupsionit e krimit të organizuar, të cilat gërryejnë shoqërinë, thellojnë pabarazinë e padrejtësinë sociale, si dhe cenojnë rëndë sigurinë kombëtare**



e njeriut dhe shtetit e së drejtës, për të mbrojtur dhe promovuar interesat e shqiptarëve kudo që ndodhen, për të ruajtur identitetin kombëtar, për të sotmen dhe brezat e ardhshëm. Sot më shumë se

kurrë kërkohet unitet dhe bashkëpunim i klasave politike. Vetëm një bashkërendim i tillë do të na mundësojë të arrijmë objektivat tona kombëtare.

Unë do të inkurajoj dhe mbështes çdo veprim, për të arritur marrëdhënie të shëndosha ndërmjet institucioneve kushtetuese.

Të garantosh zbatimin e Kushtetutës nënkupton zbatimin e ligjit edhe për të ndëshkuar korrupsionin dhe krimin e organizuar. Të vijojmë në rrugën e reformës në drejtësi, jo thjesht sepse ky është një kusht thelbësor në procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian, por edhe sepse ndërtimi i një sistemi gjyqësor të pavarur, dhe me integritet, garanton luftë pa kompromis kundër korrupsionit e krimit të organizuar, të cilat gërryejnë shoqërinë, thellojnë pabarazinë e padrejtësinë sociale, si dhe cenojnë rëndë sigurinë kombëtare. Reforma në Drejtësi me ndihmën e aleatëve tanë strategjikë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Europian, po jep frytet e saj. Përfitoj këtu nga rasti të shpreh mirënjohjen për ndihmën e pakursyer të partnerëve tanë euroatlantike. E po ashtu e gjej të udhës të ritheksoj se tek Shqipëria dhe shqiptarët, miqtë tanë do të gjejnë kurdoherë partnerin e tyre të besuar. Unë kam privilegjin, që të marrë detyrën në një nga momentet më të rëndësishme të shtetit shqiptar në raport me aspiratën, vlerat dhe ëndrrën tonë europiane.

Mbajtja e Konferencës së parë Ndërqeveritare me Bashkimin Europian, është një arritje e madhe, mëse e merituar nga Shqipëria dhe shqiptarët, falë reformave të ndërmarrta.

Pas një rrugëtimi të gjatë, me shumë përpjekje, sfida dhe detyrime, kjo ngjarje shënon vetëm fillimin e një kapitulli të ri, në të cilin do duhet të jemi të gjithë bashkë, krah për krah. Shqipëria megjithëse e vogël, dëshmon me krenari se edhe popujt e vegjël prodhojnë siguri dhe kontribuojnë në sigurinë rajonale dhe globale. Ky fakt provohet nga angazhimi ynë në arenën ndërkombëtare – angazhimi diplomatik në kuadër të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, si dhe angazhimi i Shtetit Shqiptar, për të dënuar agresionin rus ndaj integritetit territorial të një vendi sovran si Ukraina. Njëzëshmëria e klasës politike shqiptare për të mbështetur kauzën e popullit ukrainas, por edhe gjestet individuale të qytetarëve tanë, në mbështetje dhe ndihmë të popullit ukrainas, tregojnë gjithashtu se ne dimë të jemi së bashku për kauza të mëdha.

Qenia jonë në NATO, rreshtimi ynë në këtë aleancë moderne, angazhimi me përkushtim i Forcave tona të Armatosura, e bën Shqipërinë më të fortë, më të qetë dhe më të sigurtë. Por lufta në Ukrainë tregon se siguria dhe paqja e qëndrueshme nuk dhurohen, ato fitohen. Ndaj një nga detyrat më të rëndësishme të një vendi është të garantojë sigurinë e tij. Ne jemi të vetëdijshëm që faktorët e rrezikut kanë ndryshuar. Në ushtrimin e mandatit tim, vëmendja ndaj çështjes së sigurisë kombëtare do të jetë gjithmonë e madhe në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë aktorët që janë të ngarkuar nga ligji.

Të rishikojmë Strategjinë tonë të Sigurisë Kombëtare, për të pasur një reagim të menjëhershëm.

Të sigurojmë jo thjesht mbrojtjen nga kërcënimi, por të punojnë për parandalimin e elementëve që kërcënojnë sigurinë e vendit tonë. Është përgjegjësi për të gjithëve ne, të mendojmë për adresimin e situatave me të cilat përballlemi.

E gjithë shoqëria duhet të angazhohet, të diskutojë hapur dhe me kurajo, të përfshihet në mënyrë aktive për të forcuar dhe zgjeruar themelet e demokracisë. Themele ku Edukimi dhe Arsimimi, përbëjnë pa dyshim dy nga shtyllat kryesore me një

OBVL, mesazh urimi për Presidentin Begaj

I nderuar Shkëlqesi Presidenti Begaj!

Duke mirëpritur zgjedhjen Tuaj në postin Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Kryesia e Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të Luftës (OBVL) ju shpreh urimet më të përzemërta dhe Ju uron suksese në përmbushjen e misionit tuaj historik.

Ashtu si edhe gjatë mandatit tuaj si Shef i Shtabit të Përgjithshëm të FA të RSH, kur mes nesh kemi patur bashkëpunim të frytshëm, shprehim bindjen se ky bashkëpunim, do të vijojë edhe në funksionin tuaj të kryetarit të shtetit, me objektiv mbrojtjen e vlerave të LANÇ, evidentimin, promovimin dhe vlerësimin e personaliteve të saj.

Siç mund të jeni në dijeni, OBVL e themeluar dhe drejtuar për më shumë se dy dekada nga Dr.Ymer Dishnica-Nderi i Kombit dhe gjeneral Rrahman Parllaku – Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit, dhe që ka patur bashkëthemelues edhe dhjetra personalitet tjera të LANÇ e të Ushtrisë Shqiptare si: Nexhip e Sami Vinçani, Edip Ohri, Skënder Malindi, Liri Belishova etj, ka synuar dhe synon të vlerësojë realisht historinë e luftës së lavidshme Nacionalçlirimtare, që të shmangë shtrembërimet e periudhës së regjimit totalitar, mohimet dhe politizimet e bëra nga regjimi diktatorial i E.Hoxhës, por edhe me qëllim të caktuar nga individë që kërkonin dhe kërkajnë lavdi dhe pushtet të pamerituar.

Si vijuese e asaj platforme, OBVL është e gatshme të japë kontributine saj në procesin e rishkrimit me objektivitet të historisë.

Ndërkohë, edhe në kuadrin e Federatës Shqiptare të Veteranëve, të krijuar disa muaj më parë nga OBVL dhe Organizata e Veteranëve të LANÇ të Kosovës, ju konfirmojmë mbështetjen e kësaj Federate në realizimin e programit tuaj, të shpalosur gjatë fjalës pas betimit në parlamentin shqiptar si President i Republikës.

Ne vlerësojmë veçanërisht angazhimin në fillimin e mandatit tuaj, vetëm disa ditë pasi vendi ynë ka arritur një moment historik në rrugën e tij drejt BE-së, me bindjen se do jeni projeksioni i Shqipërisë dhe institucioneve të saj në përmbushjen e të gjitha detyrimeve në kuadrin e bisedimeve të anëtarësimit dhe konsolidimin e marrëdhënieve BE-Shqipëri.

Duke shprehur edhe një herë urimet në emër të Kryesisë së OBVL, Ju lutem pranoni, zoti President Begaj, shprehjen e konsideratës sonë më të lartë.

KRYESIA E OBVL
Tiranë, më 25.07.2022.

(Vijon në faqen 11)

OPINION

Samiti i Madridit dhe Shqipëria

NGA HALIL RAMA

Në Samitin e NATO-s që u zhvillua në Madrid, Spanjë, përveç ministrit të Mbrojtjes, Niko Peleshi, si pjesë e delegacionit shqiptar të kryesuar nga kryeministri Edi Rama, ishte edhe zëvendëshefja e Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Manushaqe Shehu. E vetmja grua shqiptare me gradën gjeneralmajor, aktualisht numri një i Forcave tona të Armatosura (e komanduar, pas zgjedhjes së ish-Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, Bajram Begaj, në funksionin e Presidentit të Republikës), ajo e vlerëson mbajtjen e këtij Samiti 3 – ditor si një moment historik, për vendimet mjaft të rëndësishme që u morën për orientimin e kursit të sigurisë dhe mbrojtjes në një situatë delikate sigurie, ku Rusia dhe Kina vijnë të sfidojnë rendin botëror të bazuar në rregullat ndërkombëtare.

Parë në këndvështrimin e strategjisë sonë të mbrojtjes, gjeneralmajor Shehu evidenton vlerësimin e rolit të Shqipërisë si aleate e NATO-s nga Presidenti i SHBA, Joe Biden, dhe sekretari i Përgjithshëm i Aleancës, Jens Stoltenberg. Dhe ky vlerësim nuk është i rastësishëm. Referuar edhe vlerësimit të ambasadores së SHBA në vendin tonë, Yuri Kim, në 13-vjetorin e anëtarësimit të vendit tonë në Aleancë, se roli dhe



vlerat e Shqipërisë si aleat i NATO-s vijnë të rriten në mënyrë të vazhdueshme dhe se së shpejti ekspertë amerikanë do të nisnin një program të ri, i cili do të sigurojë që Shqipëria përmbush objektivat e kapaciteteve të NATO-s, gjeneralmajor Shehu, veç të tjerash e argumenton

këtë me faktin se aktualisht, ushtarakët shqiptarë janë pjesë e mijëra trupave të vendeve të NATO-s, të cilët shërbejnë në operacionet dhe misionet e Aleancës në vendet baltike, Poloni, Rumani, Bullgari dhe në Kosovë. Po ashtu, edhe për faktin se Shqipëria kontribuon në rritjen e gatishmërisë së forcave aleate dhe mod-

ernizimin e strukturës së komandës ushtarake. Paralelisht, Shqipëria, bazuar në pozicionin e saj gjeografik dhe si anëtare fillestare e Koalicionit Global kundër të vetëquajturit "Shtet Islamik", ajo mbështet aktivisht rolin e intensifikuar të NATO-s në luftën kundër terrorizmit si dhe projektimin e stabilitetit në dhe përreth zonës euroatlantike.

Në takimet e shtuara të nivelit të lartë politik në NATO, që prej datës 24 shkurt të këtij viti, Shqipëria, krahas vendeve të tjera të NATO-s, ka dënuar ashpër sulmin e provokuar të Rusisë ndaj Ukrainës, duke e cilësuar atë si një shkelje të rëndë të së Drejtës Ndërkombëtare dhe si një kërcënim tepër serioz për sigurinë euroatlantike. Gjithashtu, Shqipëria është pjesë e vullnetit të palëkundur të NATO-s për të bërë gjithçka që duhet për të siguruar dhe mbrojtur të gjithë vendet aleate.

Rolin e vendit tonë në Aleancë, zëvendëshefja e Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Manushaqe Shehu e sheh edhe në kuadrin e përpjekjeve të Aleancës për mbrojtjen dhe sigurimin e territorit të Aleancës Atlantike, ku Shqipëria është dhe do vazhdojë të jetë plotësisht e angazhuar për të dhënë kontributin e saj në suazën e NATO-s. Kështu, pohon gjeneralmajor Shehu, në dimensionin thelbësor aleat të Mbrojtjes dhe Shkurajimit, Shqipëria kontribuon ushtarakisht në përfundimin më të madh të mbrojtjes kolektive që nga Lufta e Ftohtë, nëpërmjet vënies në jetë të Pranisë së Përpëruar të NATO-s në Lindje –EFP (Enhanced Forward Presence).

Nga Samiti i Madridit, ajo evidenton gjithashtu, se një vëmendje e veçantë që iu kushtua rajonit të Ballkanit Perëndimor, i cili vlerësohet si një rajon me rëndësi strategjike për Aleancën. Kjo edhe për faktin se në këtë Samit u theksua se vendet e tij që aspirojnë për anëtarësim në strukturat euroatlantike, do të kenë mbështetjen nga Aleanca.

Qeveria shqiptare shprehu vlerësimin e saj për marrëveshjen e arritur mes Suedisë, Finlandës dhe Turqisë, që i hap rrugë anëtarësimit të dy vendeve nordike në NATO. Kryeministri Edi Rama propozoi nga ana e tij që Kosova të ftohet menjëherë në mekanizmin e Partneritetit për Paqe, duke kërkuar nga vendet që nuk e kanë njohur të vlerësojnë qëndrimin e tyre.

Kryetarët e shteteve dhe qeverive të vendeve të NATO-s miratuan Konceptin e ri Strategjik të Aleancës, duke përcaktuar prioritetet kryesore dhe qasjet për adresimin e sfidave për dekadën e ardhshme. Ndryshe nga Koncepti Strategjik i vitit 2010, i cili e cilësonte Rusinë si "partner strategjik", koncepti i ri e paraqet atë si "rreziku më i madh i drejtpërdrejtë i Aleancës", ndërsa Kinën si një vend në rritje dhe me politika ambicioze për të sfiduar interesat dhe sigurinë e Aleancës.

Pikërisht në këtë këndvështrim i sheh vendimet dhe rëndësinë e këtij samiti drejtuesja kryesore e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, gjeneralmajor Manushaqe Shehu (nga data 16 janar 2018 e në vijim kryen detyrën e zëvendëshefit të SHP të FA), e cila vjen në këtë funksion mjaft të rëndësishëm pas një karriere të shkëlqyer në të gjitha nivelet e Ushtrisë Shqiptare. Veçanërisht gratë dhe vajzat oficere krenohen me profilin e shëfës së tyre, doktore e shkencave, gjeneralmajor dhe juriste. Mbi të gjitha, tek ajo spikasin vlerat njerëzore. Personaliteti dhe karakteri i saj në asnjë rast nuk devijoi, por u shpalos me dinjitet për më shumë se tri dekada në funksion të zhvillimit dhe modernizimit të Forcave tona të Armatosura. Ishte nga të parët që i fali shpirtin dhe zemrën ëndrës së dëshiruar në vite. Në këtë përditshmëri, ajo mbetet një nga figurat më interesante si përfaqësuese e elitës intelektuale shqiptare.

HOMAZH

HAKI OSDAUTAJ, VEPRIMTAR I SHQUAR I BASHKIMIT KOMBETAR

Nga Ismet Balaj

Haki Osdautaj, lindur më 1936 në Isniq të Pejës, është ndarë nga jeta. Ishte aktivist i shquar dhe patriot i çështjes Kombëtare Shqiptare. Ishte nga një familje e mirënjohur patriotike. Që në moshë të re u bashkua me Levizjen Nacional Demokratike Shqiptare që vepronte në ilegalitet në Pejë e në mbarë Kosovën.. Qëllimi i kësaj lëvizje ishte çlirimi i Kosovës nga pushtuesit serbë dhe bashkimi i saj me Shqipërinë amë. Kjo lëvizje e mbajti gjallë frymën e dashurisë për realizimin e kësaj ideje madhore për të cilën janë bërë fli me qindra e mijëra bijë e bija të Kosovës. Veçanërisht në vitet pesëdhjetë të shekullit XX veprimtaria e tyre u ngrit në një shkallë më të lartë. Grupi i Isniqit ku bënte pjesë edhe Hakiu, merrte materiale në gjuhen shqipe nga Shqipëria dhe e shpërndante në fshat e në rrethinë. Grupi guxoi dhe ngriti flamurin Kuq e zi në shkollën fillore të Isniqit. Kjo veprimtari aktive i shqetësoi shumë organet policore e ushtarake jugosllave. UDB-ja zbuloi disa prej tyre dhe bëri arrestime. Në këto rrethana, qëndrimi në Kosovë i Hakiut dhe i disa të tjerë veprimtarë në grupet Nacional Demokratike Shqiptare, u bë i pamundur, prandaj edhe u larguan nga Kosova dhe erdhën në Shqipëri. Hakiu jetoi e punoi dhe u shua në qytetin Bajram Curri. Mbaroi Universitetin Shtetëror të Tiranës në Degën Histori Gjeografik dhe u emërua mësues i Shkollës së Mesme "Asim Vokshi" në Bajram Curri. Mësoi dhe edukoi breza të tërë va-



që duhej të realizohej nga brezat e rinj. Aty punoi për 30 vite deri sa doli në pension në vitin. Gjatë gjithë jetës ai e kishte në shpirt Kosovën e bijtë e saj. Kurrë nuk rreshti së punuari për idealin e madh të bashkimit kombëtar.

Megjithëse ishte në moshë të thyer 64 vjeç u bë aktiv edhe në vitet 1998-1999, si përkrahës e ndihmues i UÇK-së me mjete të ndryshme që në atë kohë u bënë duke e kthyer shtëpinë e tij në një bazë mirëprirje e strehimi të kosovarëve që u dëbuan nga trojet e veta prej ushtrisë serbe. Jo vetëm kaq. Njëkohësisht, ai u bë shoqëruar i atyre që vinin nga Njujorku, Gjermania, Turqia e tje i sillnin në Bajram Curri materiale luftarake, si armë e municione, veshmbathje, ushqime e medikamente farmaceutike për luftëtarët e

lirisë. Njëkohësisht ai shoqëronte edhe të rinjë kosovarë që ktheheshin nga emigracioni si nga Gjermania, Suedia, Zvicra, Austria dhe hynin në Kosovë si luftëtarë.

Nga Bajram Curri deri në kufi me Kosovën, në Padesh-Shipshan, Hakiu kreu e këtë punë serioze e me përgjegjësi të madhe në vitet 1998-1999. Në këto vite luftime [lirimtare të Kosovës Tropoja, Hasi e tje u bënë prapavija të UÇK-së. U aktivizua si kurrë më parë edhe spiunazhi serb, po ashtu edhe hajdutë e kriminelë ordinerë. Këta sollën edhe pasojat të rënda jo vetëm grabitje materiale, por edhe vrasje të atyre luftëtarëve që sillnin materiale për UÇK-në, si Ilir Kunasheci, Hazir Malaj etj. Prandaj të ishe shoqëruar vullnetar sidomos në një moshë të thyer, duhej guxim e trimëri e rrallë, sepse rreziku ishte i madh.

Çlirimin e Kosovës nga UÇK-ja e NATOJA dhe pavarësimin e saj e shihet si një veprim ideal në rrugën e bashkimit kombëtar. Këto 23 vite të Kosovës pa pushtues serbë, i përjetoi më shpirt, duke besuar se po vinte dita e bashkimit të gjithë shqiptarëve në Ballkanin Përendimor.

La pas një emër të nderuar e të respektuar në shumë shokë, miq, dashamirë, e shumë e shumë breza ish nxënësish të rrethit të Tropojës. Po ashtu la pas edhe bashkëshorten, dy vajza e një djalë.

Haki Osdautaj hyn në historinë e popullit tonë dhe do të mbetet si veteran dhe patriot i shquar me një veprimtari të gjerë gjysmë shekulli në shërbim të bashkimit kombëtar shqiptar. Do të kujtohet ndër breza.

HISTORIA

SIPAS ROMANIT HISTORIK "ULTIMATUM" TE PETRO MARKOS



Nga Sakip Cami

"Ç'është kjo që po dëgjojmë Shqiptarët po luftojnë Me një mbret dyzet milionë"

Italianët nuk donin të hiqnin dorë nga ishulli i Sazanit dhe qyteti i Vlorës, nga rrethinat e saj, megjithë vendimet e Konferencës së Paqes. Ata ishin shtruar mirë në Vlorë që nga viti 1914 gjatë luftës së parë botërore me qëllim final italianizimin e kësaj zone. Në fillim e filluan me burgosje e internime, me vrasje e dënime për të trembur e përkulur këtë popull me histori. Filluan të shfrytëzojnë dhe pasuritë e bitumit, naftës dhe ato medicinale. Në fillim vunë flamurin shqiptar krahas flamurit italian. Kështu e mbajtën deri më 15 maj të vitit 1916. Pas 17 majit e hoqën fare flamurin shqiptar. Në gusht të atij viti hoqën edhe shkrimet e tabelave dhe zyrave dhe i zëvendësuan ato me gjuhën italiane. Që nga 15 shtatori i vitit 1916 valonte vetëm flamuri italian. Vlorën e binjakëzuan me qytetin e Leçes të Rajonit të Pulias. Vlonjatët nuk kalonin më nga bashkia se nuk duronin flamurin italian të varur në godinën e saj.

Italianët i shkulte vetëm pushka. Dhe për këtë morën vendimet burrat e Vlorës dhe të Shqipërisë. Vendosën të festonin 28 nëntorin e vitit 1919, festën e flamurit tonë kombëtar, festën e pavarësisë. Burrat kuvendonin duke pirë duhan dhe duke marrë vendime.

Për festimin e 28 nëntorit u hartua një program i veçantë dhe u kërkua leja e festimit që më parë. Kjo u vendos që në mbledhjen e parë që u mbajt tek lokali kafe i Hamza Isait. Pjesëmarrja do të ishte shumë e madhe me të gjitha krahinat e Vlorës dhe rreth e përqark. Një kryesi e përbërë prej tre vetësh nën drejtimin e Osman Haxhiut ju drejtua komandantit të fuqive italiane në Ballkan, Gjeneralit Ferrero për lejen e festimeve. Gjenerali italian kundërshtoi në mënyrë kategorike. Ai tha se do të lejonte ngritjen e flamurit kombëtar, por nuk do të lejonte tubime masive dhe se do të merrte masa kundër atyre që do të tuboheshin rreth flamurit. Osman Haxhiu ju përgjigj flakë për flakë: "Ne do ta festojmë me çdo kusht dhe me çdo çmim festën e pavarësisë sonë. Askush nuk mund ta ndalojë popullin që të kremtojë festën e pavarësisë së tij. Ju bëni ç'të doni" dhe doli si furtunë nga zyra e gjeneralit italian.

Komiteti organizator kishte marrë masa për festime, por nuk donte të kishte gjakderdhje. Populli ishte njoftuar deri në krahinat e largëta. U hap fjala se italianët nuk do të lejojnë festime në qytet. Por nga ana tjetër u hap fjala se populli do të mblidhej tek xhamia dhe tek kisha për ceremoni fetare dhe se më pas do të shpërndahej qetësisht. Kjo ishte sa për sy e faqe, sa për të vënë në gjumë autoritetet italiane.

Të nesërmen më 28 nëntor 1919 ora 09.00 një grup hoxhallarësh me myftinë në krye si dhe kleri katolik e ai ortodoks të shoqëruar nga Osman Haxhiu dhe anëtarët e Komitetit organizator, me tre djemtë e Ismail Qemalit,

LUFTAT E

dymbëdhjetë djem të rinj të veshur me kostume kombëtare dhe me flamurin kombëtar të qëndisur me ar u drejtuan tek Xhamia Plakhanë. Pas tyre hyri në xhami i tërë populli i pranishëm. Binin në sy edhe nxënësit e shkollave të drejtuara nga patrioti dhe profesori i tyre Jani Minga. Pas lutjeve dhe riteve fetare dhe pas fjalimit patriotik të Jani Mingës populli me flamur në dorë u drejtua drejt rrugës së madhe duke manifestuar me thirrje e brohoritje:

"Rroftë Shqipëria !"

"Rroftë Flamuri Kombëtar !",

"Të huajt jashtë Shqipërisë !"

Ndërhynë menjëherë 200-300 karabinjerë të armatosur me revolver dhe me shpata që përpiqen të shpërndajnë turmën. Një major italian që ndodhej para karabinierisë urdhëroi me megafon: "Osman Haxhiu të shpërndajë turmën". Osmani bën sikur nuk dëgjon dhe turma vazhdon të shtyhet përpara duke bërë turmë:

"Rroftë Shqipëria e pavarur !"

"Të gjithë, me flamujtë tanë kombëtarë në duar !"

"Ta rrëzojmë flamurin italian !"

"Vlora është e jona."

"Është e jona Shqipëria."

"Rroftë flamuri !"

"Rroftë 28 nëntori !"

"Rroftë liria !"

Karabinjerët godasin flamurin me shpata dhe bajoneta dhe rrethojnë Osman Haxhiun për ta arrestuar, por mbeten vetë të rrethuar nga turma e madhe popullore. Një pjesë e turmës me Osman Haxhiun hyn në xhami dhe del nga dera e pasme e saj. Populli egërsohet Nervozizmi arrin kulmin. Flamurin, ndonëse të grisur nuk e lëshojnë nga duart.

"Me duar, o djem, me duar, sakën se përdorni armët", - thirri Duro Shaska për të evituar gjakderdhjen.

Karabinjerët u rrëmbejnë fëmijëve të shkollave një flamur dhe ja vendosën në qafë një qeni. Protestuesit fyhen deri në tërbim. Egërsimi vazhdon edhe më i madh. Vazhdon përlëshja në shesh. Ka shumë të plagosur, njerëz të shtirë përdhe, midis tyre edhe fëmijë. Ka edhe shumë karabinjerë të plagosur. Populli shpëndahet duke kaluar rrugë më rrugë, kafe më kafe, duke kënduar hymnin kombëtar. Dita e flamurit u festua edhe nëpër krahina e fshatra. Një kryengritje e madhe po përgatitej.

Vlora kishte jo pak, por tre gjeneralë. Gjenerali Ferre-

ro, gjeneral Piacentini dhe gjeneral Gotti i sapo graduar. Në Vlorë ishin 45 mijë forca ushtarake. Po zona që kishin pushtuar sa frymë bëhej? Gjenerali para hartës fillon e bën llogaritjet. Vlorë, Tepelenë, Drashovicë, Gjërm, Brataj, Kuç, Himarë, Dukat, Kaninë gjithsej 32 mijë frymë. Po si është e mundur që të mos bëjmë zap një popull kaq të vogël?

Gjeneral Piacentini ëndërronte që një kohë të shpejtë të bëhej politikan dhe të bëhej mëkëmbës i Mbretit të Savojës për Vlorën, të shëtiste me jaht në Sazan, Karaburun e Ujë të Ftohtë e të udhëtonte kudo në Adriatik.

Vartësit i thonin burri i Xhinës së bukur. Kur u martua me Xhinën ishte vetëm major dhe më pas i ngjiti shkallët e karrierës deri në gjeneral. Kështu si e kishte nisur me Xhinën me vehte në çdo ballo zyrtare së shpejti do të bëhej edhe gjeneral me katër yje. Por Xhina e kishte mendjen te koloneli, zëvendësi i gjeneral Piacentinit.

Gjeneral Gotti ishte kolonel dhe u gradua në Shqipëri, kur u emërua komandant i garnizonit të Kotës. Ngado që shkonte merrte edhe rruspijat me vehte. Ndërsa gjeneral Ferrero ishte për drejtimin e Ballkanit, por nuk po nënshtronte as edhe një qytet.

Vlonjatët në dasma hidhnin valle dhe këndonin këngë humoristike për tre gjeneralët. Azemi nga Dukati e kishte ngritur vetë këtë këngë:

"Xheneralë italianë janë tre/ Xheneral me tre nishanë është një/ Është Ferrero kumandar, bej, o be/ Që s'të zunë këmbët dhe, bej o be/ I dyti sinjor Piacentini, kokëbosh/ E njihni, apo s'e njihni? Si kaposh/ Dhe i treti më i riu, shumë i zoti/ Male fusha i përpiu, është Gotti".

Për Luftën e Vlorës erdhën edhe djemtë nga Amerika Jaho Sinani, Bezat Hysi, Bilal Nivica, Etem Toto, Tahir Xhaferi, Aqif Përmeti, Kolonel, komandant i Regjimentit, Lutfi Bença, Myslym Bença, Hasan Bença, Kristo Bezhan, Prokop Bezhan, Rait Gume, Hamit Kaba e shumë e shumë të tjerë, një njësi e tërë ushtarake.

Më 29 mars 1920 bashkë me regjimentin e komanduar nga Kolonel Aqif Përmeti erdhi edhe banda muzikore e "Vatrës" e drejtuar nga Prof. Thoma Nasi.

Korça u muar në dorzim nga ushtria franceze në maj të vitit 1920. Më 20 prill 1920 Fuqia Kombëtare hyri në Gjirokastrë dhe u prit me lule nga populli. Fuqia kombëtare e bashkuar edhe me milicinë e Gjirokastrës hyri edhe në Delvinë.

Në fushën e Luzatit, afër Tepelenës, italianët kishin vënë afishe ku shkruhej se do të goditeshin me top të



HISTORIA

VLORËS

gjithë ata që do të kalonin të armatosur. Për këtë formohet një komision i cili shkon në Tepelenë dhe takohet me komandantin e regjimentit Italian. Ky komision ja bën të qartë komandantit Italian se xhandarmëria shqiptare ka ardhur të marrë në dorzim administratën e vendit. Komandanti Italian deklaroi se përveç bandës së "Vatrës" nuk do të pranojë asnjë autoritet tjetër të armatosur.

Rreth 700 forca popullore rrethojnë garnizonin ushtarak Italian me 500 ushtarë që ndodhej në kalanë e Tepelenës. Pas dy ditë luftimesh italianët, të ndodhur edhe pa logjistikë të mjaftueshme, dorzohen, ngrënë flamarin e bardhë. Disa oficerë italianë dolën nga kalaja dhe kërkuan takime për bisedime me udhëheqësit e kryengritjes. Nga ana e kryengritësve shqiptarë në komision ishin Aqif Përmeti, Baba Ahmet Turhani, Jaho Sinan Islami, Azis Çami, Sulejman Luzati, Ahmet Kajca, Ali Bej Këlcyra, Riza Cerova. Komisioni u kërkoi italianëve që të dorzojnë armët, pasi edhe Drashovica dhe Kota kishin rënë dhe ushtria italiane atje ishte dorzuar.

Majori italian, Kolcini, nuk e besoi deklaratën dhe kërkesën e komisionit të kryengritësve dhe kërkoi ta verifikonte me anën e një togeri, të cilin e shoqëroi Haxhi Shehu. Nga Tepelena shkuan me makinë në Drashovicë dhe atje panë se kjo zonë ishte çliruar. Të nesërmen, pas kthimit të togerit nga Drashovica, italianët në Tepelenë pranuan të dorzonin armët, por me një kërkesë që në çdo dhjetë ushtar, të mbajë një armë dhe të lireshin të lirë të shkonin në Sarandë. Kjo kërkesë nuk u pranua, por u lejua vetëm që oficerat të mbanin pistoleta dhe dylbi, ndërsa të shkonin në Vlorë dhe jo në Sarandë.

Me 21 qershor 1920 rreth orës katër mbas dite Tepelena ishte e lirë dhe trupat italiane u nisën drejt portit të Vlorës, të shoqëruar nga luftëtarët shqiptarë. U zunë robër 301 ushtarë italianë, një major dhe shumë oficerat të tjerë. U zunë gjithashtu armatime dhe logjistikë, dy topa, 14 mitrolozë, 300 pushkë, 6 mitroloza dore, 70 mushka, 35 makina telefoni, 2 makina telegrafi, 50 biçikleta, 32 karro.

Në qershor 1920 tepelenasit u nisën në luftën e Vlorës. Në ballë u printe Selam Musai. Më 3 shtator 1919 në Vlorë ishte formuar Komiteti përfaqësues i krahinave dhe qytetit të Vlorës i përbërë nga 12 vetë.

Qytetin e përfaqësonin: Qazim Kokoshi, i cili kishte mbaruar gjimnazin "Zosimea" të Janinës, anëtar i Klubit atdhetar "Labëria", përfaqësues i Vlorës në Kuvendin e Gerçes. Osman Haxhiu, që kishte mbaruar Kolegjin amerikan të Stambollit, i biri i Haxhi Muhametit, njeri i pasur dhe me famë në Vlorë, prefekt i Vlorës dhe burrë shteti. Kol Tromara, pjesëmarrës aktiv i Federatës "Vatra" të shqiptarëve të Amerikës. Më 29 mars 1920 vjen në Shqipëri me vullnetarët e "Vatrës". Krahina e Dukatit përfaqësohej nga Imer Radhima, Mesapliku nga Ahmet Lepenica, Kudhësi nga Rrapo Çelo, Treblova nga Qazim Koculi, Drashovica nga Idriz Ladrri, Topalltia nga Mystehak Oshtima. Komiteti kryesohej nga Hamza Isai. Ai qëndronte në Vlorë, por kishte lidhje me të katër anët e Shqipërisë. Anëtarë të këtij komiteti ishin burra të tillë si Qazim Koculi, nga Treblova, komandant i përgjithshëm, Hysni Shehu, veprimtar i Klubit patriotik "Labëria", mik i ngushtë i Ismail Qemalit. Mustafa Abazaj, i biri i patriotit Lulo Abazaj, i shquar në luftën kundër turqve. I pari që përhapi alfabetin shqip në Tërbaç. Një dhomë të shtëpisë së tij e kishte bërë shkollë. Myqerem Hamzaraj, student i Robert Kolegjit Amerikan të Turqisë. Në vitet 1918-1920 ka qenë një nga figurat kryesore atdhetare të Vlorës. Në moshën 25 vjeçare u bë anëtar i Komitetit të Mbrojtjes Kombëtare.

Ahmet Lepenica, bashkëluftëtar i Mustafa Qemal Atatürkut. Kishte luftuar me armë në dorë për mbrojtjen e pavarësisë si dhe për çlirimin e krahinave të Jugut nga shovinistët grekë. Mori pjesë në mbrojtjen e Kongresit të Lushnjës. Më 29 maj 1920 u zgjodh kryetar i komisionit të oficerëve që do të drejtonte Luftën e Vlorës. Më 4 qershor 1920 bëhet koman-

dant i trupave kombëtare. Alem Agai përkrahu ndër të parët lëvizjen kombëtare patriotike. Shkriu pasurinë e tij për atdheun. Në qeverinë e Ismail Qemalit u emërua komandant i xhandarmërisë shqiptare dhe mori gradën major. Beqir Agalliu, aga fisi i Agallinjve të qytetit të Vlorës. Ndërtoi edhe një xhami që mori emrin xhamija e Agallinjve. I arsimuar në Itali. Ishte në krye të demonstratës së 28 nëntorit të vitit 1919. Sali Bedini, Lindur në Armen të Vlorës, në lagjen e agallarëve, njeri me pasuri të madhe. Ishte anëtar i Klubit "Labëria". Mori pjesë në Kuvendin e Drashovicës ku u miratua memorandum i Gerces. Duro Shaska, një nga mbështetësit më të mëdhenj të Ismail Bej Qemalit. Ka luftuar kundër andartëve grekë në Tepelenë dhe kundër forcave të Haxhi Qamilit. Një nga familjet më të pasura të Vlorës. Tregoi guxim dhe mençuri të madhe në demonstratën e 28 nëntorit të vitit 1919. Ali Bej Këlcyra i diplomuar për drejtësi në Universitetin e Romës. Zotëronte pesë gjuhë të huaja, frëngjisht, anglisht, italisht, greqisht dhe serbisht. Mori pjesë në Luftën e Vlorës si komandant i forcave të Dishnicës dhe Përmetit. Luftoi në Nartë. Hysni Lepenica nga Lepenica, kishte kryer arsimin mesëm në Kolegjin e Shën Adrianit në Shën Mitër të Kalabrisë 1914-1918. Mësues gjuhe në periudhën 1918-1919. Komandant në çetën e Lepenicës në Luftën e Vlorës në vitin 1920.

Kryeministri Sulejman Delvina dhe ministri i brendshëm Ahmet Zogu, dy burrështetas të fuqishëm që e përkrahën pa rezerva Luftën e Vlorës siguruan përkrahje, mbështetje, forca dhe armatime edhe nga Tirana, Elbasani, Peqini, Berati, Gjirokastra.

Fill pas Kongresit të Lushnjës, Sulejman Delvina shkoi në Vlorë të shikonte nga afër gjendjen. Qeveria shqiptare nuk mund të pranonte që në Vlorë të qëndronin akoma italianët.

Kryengritësit e Labërisë e siguruan udhëtimin dhe qëndrimin e tij në Vlorë. Totua ishte shoqëruesi i tij kryesor. Amanet kryeministrin, i kishte thënë Osman Haxhiu. Totua e shihte me admirim kryeministrin. Goxha kryeministër, ma kanë besuar mua.

Gjenerali italian tërbohet nga inati. Si mundet të vijë ai në Vlorë pa lejen time. Dalëngadalë situata po i dilte jashtë kontrollit.


Një luftë e përmasave të jashtëzakonshme për një vend të vogël si Shqipëria dhe një krahinë si Labëria. Nga Tirana kishin ardhur forcat e komanduara nga Major Ismail Haki Kuçi dhe Major Ismail Haki Bej Libohova. Nga Korça kishin ardhur forcat e komanduara nga Kapiten Ferit Frashëri, Sami Koprencka e Tosun Selenica. Nga Çamëria erdhën forcat e komanduara nga Alush Taka e Muharem Rushiti. Nga Gjirokastra kryesonte forcat Javer Hurshiti e Xhevdet Picari. Nga Peqini erdhën forcat e komanduara nga Adem Gjinishi. Nga Mallakastra i komandonin çetat Bektash Cakrani, Telo Zace Behaj, Kamber Belishova e Hysni Toska, nga Mallakastra e egër Halim Hamiti, Baba Hasan Kremenari, Myslym Jonuzaj, nga Skrapari Riza Kodheli, nga Berati forcat e komanduara nga Seit Bej Toptani e Izedin Bej Vrioni. Erdhi edhe një çetë nga Amerika me në krye Aqif Përmetin dhe Karemian Tatzatin.

Kishte edhe një grup artilierësh me komandant Aziz Çamin dhe zëvendës Elmas Ademi, me artilier Xhafer Xhuveli dhe Avduraman Çiraku. Shoqëria "Vatra" e Amerikës dërgoi "Bandën" e shoqërisë së bashku me trupat vullnetare. Bandën e drejtonte muzikanti Thoma Nasi.

Luftëtarët i frymëzonin prijësit fetarë të të gjitha sekteve fetare si Babai i Teqes së Tepelenës Ahmet Turhani, Baba Xhaferi i Përmetit, Don Marku i Mirditës dhe Lezhës, At Shtjefën Gjeçovi i Shkodrës, myftiu Osman Muka, etj.

Xhovani Valencia, arbëresh nga Italia, me detyrë magazinjer ua dorzoi magazinat shqiptarëve. Në gjak i vlonte gjaku arbëror.

Në Baçalla e Dukat më 29 maj 1920, u mblodhën



rreth 200 burra të krahinës së Vlorës, për t'i dhënë përgjigje aneksimit të Vlorës nga Italia imperialiste, forca që u shumëfishuan nga e gjithë Shqipëria e mesme dhe e jugut.

Mbledhja e parë në Baçalla' u bë më 16 maj të vitit 1920. Hysni Lepenica shkon në Tragjas ku lajmëron Alem Mehmetin, Imer Radhimën, Sheme Sadikun dhe Tahir Hoxhën që të shkonin në malin e Shoshicës për tu takuar me Beqir Sulon, Muhamet Abedinin dhe Ahmet Lepenicën, të cilët ishin të ngarkuar nga Qazim Kokoshi, Qazim Koculi, Duro Shaska e Zaçe Xhevoja për të lajmëruar e për tu mbledhur nga 4-5 burra për çdo fshat në një vend larg syrit të italianëve për të bërë organizimin e luftës kundër italianëve në zonën e Vlorës, Kurveleshit dhe Tepelenës.

Në Baçalla u morën një seri vendimesh të rëndësishme. U vendos t'u shpallje luftë forcave italiane në Vlorë, dhe krahina e Vlorës të bashkohej me pjesën tjetër të Shqipërisë. U zgjodh një këshill ushtarak prej 35 vetësh, i cili emëroi një komandant të luftës dhe zgjodhi një shtab prej 12 vetësh. Komandanti nuk duhej të bënte pjesë në këtë shtab i cili u quajt "Komiteti Mbrojtja Kombëtare" ose si thirrej në popull "Komisioni". Vendimet e "Komitetit" ishin të detyrueshme për komandantin. Komandant u zgjodh major Ahmet Lepenica. Këshilli zgjodhi anëtarë të "Komitetit" Osman Haxhiun, Qazim Kokoshin, Alem Mehmetin, Beqir Agalliu, Ali Beqirin, Murat Miftarin, Hamit Selmanin, Hysni Shehun, Myqerem Hamzarain, Sali Bedinin dhe Qazim Koculin. Këta të dymbëdhjetë zgjodhën njëzëri kryetar të "Komitetit" Osman Haxhiun. Policia e luftës komandohej nga Shero Emiri e Ahmet Lepenica. Komandanti i përgjithshëm i luftës ishte Qazim Koculi.

Ky kuvend la si detyrë një grumbullim më të gjërë në Beun të Vajzës së Vlorës ku do të grumbulloheshin burrat e armatosur derë për derë.

-Te Rrapi i gurrave në Beun!

- Te Rrapi i gurrave në Beun!

Thirrja u përhap gojë më gojë. E kush nuk e njihte rrapin e gurrave në Beun të Vajzës së Vlorës. Kishin kullotur dhën e dhi. Kishin pirë qumësht dhish e kishin pirë raki me opingë. U dha porosi që të njoftoheshin edhe luftëtarët e Tepelenës, Kurveleshit dhe Mallakastrës që nuk kishin arritur të njoftoheshin më parë. Për në Beun do të grumbulloheshin çetat e armatosura. Erdhën ata, trimat e çartur, por të thjeshtë si toka që i lindi dhe i rriti, Selam Musa Salaria, Zigur Lelo Smokthina, Halim Xhelo Tërbaçi, Murat Tërbaçi, Osman Haxhiu, Mehmet Selimi, Kanan Maze, Sali Kapedan Vranishti, Jaho Sinani, Hodo Zeqiri, Thanas Beni nga Bregu, Totua, Shyqo Duka, të dymbëdhjetë e komisionit luftarak, komandantët e çetave së bashku me luftëtarët shoqërues. Fshatarët e Ramicës dhe të Velçës, të Vajzës dhe të Smokthinës, të Sevasterit dhe të Vernikut kishin vajtur më shpejt se e kishin më afër.

(Vijon në numrin e ardhshëm)

PËRKUJTIMORE

Ekzekutimet masive nga forcat serbe në Bosnjë Hercegovinë janë mizoria më e rëndë në Evropë pas Luftës së Dytë Botërore

Në Srebrenicë u përkujtuan viktimat e gjenocidit serb

Nga Bashkim Hisari

Më 11 korrik 2022 në Bosnjë-Hercegovinë u shënuar 27-vjetori i gjenocidit në Srebrenicë, një nga krimet më të rënda dhe më të tmerrshme në Evropë që prej përfundimit të Luftës së Dytë Botërore.

Nga 11 deri më 16 korrik 1995, forcat e policisë, ushtrisë dhe formacioneve të ndryshme paraushtarake të Republikës Srpska, vranë 8372 boshnjakë të pafajshëm. Deri më tani, 6671 burra dhe fëmijë janë varrosur në Qendrën Përkujtimore të Srebrenicës, trupat e të cilëve u gjetën në 84 varreza masive. Mbetjet mortore të shumë viktimave akoma ndodhen në pjesë të ndryshme të rajonit të Srebrenicës. Eshtrat e afro 1200 civilëve të vrarë, deri më tash nuk janë gjetur. Qindra nëna vdiqën para se t'i gjenin eshtrat e fëmijëve, vëllezërve dhe të familjarëve të tyre.

Në mesin e viktimave kishte disa të mitur, më i moshuari Husein Hodžić, ishte 59 vjeçar.

Më 11 korrik 2022, në Qendrën Përkujtimore në Potočari - aty ku ndodhen varret e mbi 6670 viktimave, 27 vjet pas, u rivarrosën edhe eshtrat e 57 viktimave të gjenocidit në Srebrenicë, të identifikuarra së voni me metodën DNK. Mes tyre ishin edhe copëzat e eshtrave të vajzës së mitur Fatima Muhić dhe të riut Hajrudin Halilović.

Vajzën e lindur në vitin 1995, nëna e saj Hava, e kishte pagëzuar me emrin Fatima tek në vitin 2012 kur në një varrezë masive në Potočari u identifikuan pjesët e eshtrave të njomë të foshnjës të përziera me të tjerët. Fatima e posalindur ishte viktimë më e re në gjenocidin e Srebrenicës. Forcat serbe kanë vrarë edhe burrin e Havës (babën e Fatimës) bashkë me dy vëllezërit dhe vjehrrin.

Hajrudin Halilović e kishin vrarë 27 vite më parë kur ishte 27 vjeçar. Atë ditë të kobshme, ai bashkë me babain u përpoqën të gjejnë shpëtimin në zonën e mbrojtur nga forcat paqëruajtëse të Kombeve të Bashkuara. Mirëpo, ekzekutohen në Potočari sëbashkë me shumë burra e djem boshnjakë të



- **Më 7 korrik, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, miratoi një rezolutë për kujtimin dhe nderimin e viktimave të gjenocidit në Srebrenicë dhe dënoi prirjet për ta mohuar këtë gjenocid, si dhe masakrat e krimet e tjera kundër njerëzimit në hapësirën e ish-Jugosllavisë. Në rezolutë, pos tjerash theksohet se “mohimi i gjenocidit të kryer ndaj popullatës boshnjake në Srebrenicë nga forcat serbe të Bosnjës përbën shkelje të ligjit ndërkombëtar, nxit pandëshkueshmërinë e krimeve të luftës si dhe shkel dinjitetin e mbi tetë mijë civilëve që u masakruan në Srebrenicë, familjeve të tyre dhe të mbijetuarve, si dhe shkel dinjitetin e dhjetë mijë shqiptarëve të vrarë gjatë spastrimit etnik në Kosovë dhe njëzet mijë grave të dhunuara nga regjimi serb i Slllobodan Milosheviçit”.**



pafajshëm. Mbetjet mortore të Hajrudinit janë identifikuar në një varrezë masive në bazë të një pjese të dorës së djathtë, disa gishtave të dorës, nga pak pjesë të nofullës dhe të eshtrave të gjoksit.

Ekzekutimet masive të kryera nga forcat serbe në Bosnjë Hercegovinë janë cilësuar si mizoria më e rëndë në Evropë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Gjykata Ndërkombëtare e Hagës, këto krime i ka njohur si gjenocid. Parlamenti Evropian e ka shpallur 11 korrikun ditë përkujtimore për gjenocidin në Srebrenicë.

Në Tiranë, më 7 korrik, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, miratoi një rezolutë për kujtimin dhe nderimin e viktimave të gjenocidit në Srebrenicë dhe dënoi prirjet për ta mohuar këtë gjenocid, si dhe masakrat e krimet e tjera kundër njerëzimit në hapësirën e ish-Jugosllavisë. Në rezolutë, pos tjerash theksohet se “mohimi i gjenocidit të kryer ndaj popullatës boshnjake në Srebrenicë nga forcat serbe të Bosnjës përbën shkelje të ligjit ndërkombëtar, nxit pandëshkueshmërinë e krimeve të luftës si dhe shkel dinjitetin e mbi tetë mijë civilëve që u masakruan në Srebrenicë, familjeve të tyre dhe të mbijetuarve, si dhe shkel dinjitetin e dhjetë mijë shqiptarëve të vrarë gjatë spastrimit etnik në Kosovë dhe njëzet mijë grave të dhunuara nga regjimi serb i Slllobodan Milosheviçit”.

Kohë më parë, edhe Kuvendi i Kosovës miratoi një rezolutë me të cilën “dënohet ashpër gjenocidi i shtetit serb në Srebrenicë ndaj pjesëtarëve të popullit boshnjak dhe të gjitha shkeljet e të drejtave të njeriut si dhe dënohet çdo tendencë për të mohuar

qëllimisht dhe publikisht gjenocidin e Srebrenicës, me qëllim të denigrimit të viktimave dhe fshehjes së motiveve të krimeve të kryera”. Deputetët e Parlamentit të Kosovës ftuan institucionet shtetërore që të nderojnë viktimat e gjenocidit dhe 11 korriku të shpallet ditë përkujtimi për gjenocidin në Srebrenicë. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në fjalën e tij tha se rezoluta dhe padia ndaj Serbisë për gjenocid që po e përgatitë Kosova, do të kontribuojnë që në të ardhmen të mos përsëriten ngjarje siç ndodhën në Srebrenicë.

Ngjarjet më të errëta të krimeve të forcave serbe nuk ishin rezultat i veprimeve spontane dhe të pakontrolluara, përkundrazi, gjenocidi në Srebrenicë dhe krimet në Kosovë ishin veprime më mizore të planifikuara me vetëdije, me kujdes dhe me motive politike.

Serbia ende jeton me frymën e ndjenjave të forta armiqësisë e mosmarëveshjeve që janë të mbushura me gjuhë urrejtjeje dhe me relativizimin e të vërtetës dhe fakteve për krimet e tyre. Provat dhe e vërteta për ngjarjet më të errëta dhe krimet më të rënda që kanë bërë serbët në Bosnjë-Hercegovinë dhe Kosovë, zgjojnë tek njerëzit shkallën më të ashpër të dëshpërimit, kujtimit të mizorive, vuajtjeve, humbjeve, dhimbjeve dhe trishtimeve të përpshkruara.

Zërat për krimet e kryera dhe për gjenocidin e serbëve në Bosnjë-Hercegovinë dhe në Kosovë jehojnë largë. Ata dëgjoen shumë më tepër sesa retorika e atyre që janë në pakicë dhe të cilët mohojnë krimet e tyre monstruoze.

Deri më tani, për gjenocidin dhe krimet e kryera në Srebrenicë, 47 persona janë dënuar me më shumë



se 700 vjet burg. Në Kosovë ekzistojnë informacione dhe dokumente të verifikuara për mbi 13.500 viktimë të luftës. Sipas një hulumtimi të Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), “prej tetorit të vitit 1999 deri në qershor 2020 janë dënuar nga gjyqtarë të UNMIK-ut, EULEX-it dhe ata vendorë, me aktgjykime të formës së prerë gjithsej 40 persona. Prej tyre 35 janë shqiptarë dhe katër serbë”!

Bota demokratike ka njohuri dhe ka të dhëna themelore se në Bosnjë-Hercegovinë e Kosovë, serbët projektuan, organizuan, udhëhoqën dhe kryen vrasje të tmerrshme, dhunime, gjenocid, ekzekutime masive, shkatërrime të pronave dhe gjërave tjera me vlerë, dëbuan me dhunë fëmijë e gra dhe kryen krime tjera. Megjithatë, që nga kolapset tragjike dhe të përgjakshe me e deri në ditët e sotme, politika serbe endet mes populizmit profashist dhe nacionalizmit që është manipulues duke formuar opinione për mite, besime, paragjykime stereotipe dhe duke mohuar plagët e dhimbshme të krimeve të tyre. Elita politike, intelektuale e kulturore serbe, madje edhe një pjesë e madhe e qytetarëve, kujtimet për krimet e tyre i përjetojnë si një lloj të provokimit dhe të një kompleti botëror kundër serbëve. Gjërëta justifikojnë me “interesa më të larta”, me shqetësimin për të ardhmen dhe prosperitetin e Serbisë dhe gjëra të ngjashme. Vazhdimisht kontestojnë dhe refuzojnë të ballafaqohen me të kaluarën dhe me të vërtetën për krimet e bëra. Deri më tani nuk kanë dhënë ndonjë shans dhe nuk po tregojnë vullnet për të kontribuar në ndërtimin e një të ardhmeje më të mirë, një jete të përbashkët në paqe dhe me dinjitet.

Duke besuar se Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit është diçka që nuk mund të ndryshohet dhe të përcaktohet ndryshe, pushteti serb, në preambulën e Kushtetutës, Kosovën e trajton si pjesë të saj gjë që është absurde me tërësinë e ligjeve, emocionet, historinë dhe realitetin që Beogradi zyrtar nuk dëshiron ta shohë.

Serbia vazhdon të jetë pengesë kryesore për tejkalimin e sfidave në procesin e negociatave dhe për integrimet evropiane të shteteve të Ballkanit perëndimor. Përmbyllja e dialogut ndërmjet Beogradit zyrtar dhe Prishtinës me nënshkrimin e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse detyruese për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, do të siguronte paqe dhe stabilitet të qëndrueshëm në rajon.

HISTORIA

Rruga e lavdishme heroike e Brigagës së XVIII-të

- **BRIGADA XVIII SULMUESE E UNÇSH** u formua në Sllatinë të Peshkopisë më 18.8.1944, nga batalionet partizane të Dibrës, Çermenikes e Martaneshit, si dhe me vullnetarë të rinj nga krahinat e Dibrës, që u organizuan në katër batalione. Më 22.8.1944 forcat e saj, së bashku me forcat e Br. V S zhvilluan me sukses luftimin e parë mësymës kundër forcave gjermane e reaksionare të përqendraara në malin e Korabit. Nga ky sulm armiku pati shumë humbje dhe dështoi operacioni «Filksenjagd»), që synonte të pushtonte Peshkopinë.
- **Dy batalione të Br. XVIII S, në bashkëveprim me forcat e Br. V S, më 2 shtator çliruan qytetin e Dibrës; më 21 shtator ajo goditi forcat reaksionare në rajonin e fortifikuar të Kalasë së Dodës, në Lumë, dhe i shpartalloi ato plotësisht; forca të Br. XVIII S morën pjesë në çlirimin e qytetit të Kërçovës, në këto luftime ra dëshmore edhe Hibe Palikuqi, Heroinë e Popullit; pas një vargu veprimesh luftarake kundër hitlerianëve në tërheqje, gjatë rrugës Prizren-Kukës-Pukë dhe në rrethet e Prizrenit, më 5.11. filloi goditjen kundër pushtuesve gjermanë në Kukës. Së bashku me Br. V S mori pjesë në çlirimin e Prizrenit më 16 nëntor, kurse më 17 nëntor ajo goditi e shpartalloi kolonën e ushtarëve armiq që drejtoheshin nga Prizreni në Kukës dhe në 18 nëntor çliroi qytetin e Kukësit.**



Para 78 vitesh, më 18.8.1944, në Sllatinë të Dibrës u formua Brigada e XVIII S nga batalionet partizane të Dibrës, Çermenikes e Martaneshit, si dhe me vullnetarë të rinj nga krahinat e Dibrës, që u organizuan në katër batalione.

Komandat i Brigadës XVIII S. qe Esat Ndreu dhe zëvendëskomandant Zoi Themeli, komisar Miço Kallamata dhe zëvendëskomisar Sotir Vullkani.

Më pas, komandant brigade kanë qenë edhe Zoi Themeli e Petrit Dume, ndërsa zëvendëskomandant kanë qenë edhe Petrit Dume e Xhevdet Petrela. Komisar qe edhe Ilmi Çausholli dhe zëvendëskomisar qenë edhe Temo Sejko e Milo Qirko; përgjegjës rinie Dhori Shkodrani, sektori i Agjitpropit: Qazim Prishtina (përgjegjës) Muntaz Kodra, Servet Tershana; intendent: Mahmut Ndreu, Bardhyl Papajani, Kin Dushi, oficer i mbrojtjes Mustafa Novi, oficer informativ Sakip Luku, oficer në sektorin informativ Zenulla Uka (përgjegjës i seksionit).

Brigada që në fillim, sipas detyrave që kishte marrë nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë NÇ, nën drejtimin e komandës sonë veproi së bashku me Brigadat e I, IV, e të V Sulmuese për asgjësimin e sulmeve që ndërmerrnin forcat gjermane e bashkëpunëtorët e tyre, si ajo e mësymjes së tyre nga Hilmia, por u shpartalluan dhe më 23 Gusht 1944 u çlirua Peshkopia dhe gjithë Dibra dhe kjo ditë u shpall dita e çlirimit të Dibrës.

Pas 30 Gushtit Brigada veproi në luftimet kundra gjermanëve e bashkëpunëtorëve të tyre në Lumë, Kukës e Prizren...

Kukësi u çlirua më 18 Nëntor 1944 dhe së bashku me forcat e Brigadës V-të Sulmuese u çlirua Prizreni më 17 Nëntor 1944. Pas kësaj Brigadës iu caktua detyra për asgjësimin e mbeturinave të mercenarëve dhe bashkëpunëtorëve me okupatorët nazifashistë në zonën Mirditë-Pukë.

Për të gjitha këto luftime e aksione të Brigadës është botuar Historiku i Brigadës së 18-të Sulmuese (të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare), 18 Gusht -25 Prill 1945, në vitin 2008.

Sipas kujtime të Hajri Hoxhës, ish-partisan dhe kuadër i kësaj brigade (ish-komisar i kompanisë së shtabit të Brigadës): "Pothuajse çdo natë

Batalionet e Brigadës zinin pusi në istikamet e improvizuara rreth rrugës Prizren - Kukës, poshtë fshatit Bardhoc e të tjerë deri në afërsi të Kukësit që prisnin autokolonën gjermane të tërhiqeshin nga Prizren-Kukës-Pukë-Shkodër. Po ashtu kishte javë që në ditë të caktuara për afro dy muaj batalionet me radhë ndërmerrnin aksione kundra forcave gjermane në qytetin e Kukësit. Këto jepnin rezultate në dëmtimet që u bënë si në njerëz e materiale autokolonave gjermane apo atyre të vendosura në qytet. Dhe ne të gjithë partizanët në këtë rast ruajmë pritjen që si para apo pas aksionit të fshatrave të Kukësit që nga Bicaj e Morina ndanin bukën e tyre me ne e çfarë kishin në shtëpi si groshën, dhallë e sidomos turshitë dimërore, sepse po të mos ishte kjo nga do t'i merrnim ne bukën etj. mos kishim magazinat me miell apo të tjerat? Jo, "magazinë" ishte zemra

bujare e fshatarësisë si kudo në gjithë popullin shqiptar e sidomos të fshatarësisë edhe në të Dibrës-Krumës-Kukësit-Pukës e Prizrenit".

Me çlirimin e Kukësit dhe Prizrenit u bënë ndryshime në udhëheqjen e Shtabit të Brigadës. Esat Ndreu u caktua me forcat e ndjekjes në Shkodër dhe Komandant erdhi Petrit Dume, ndërsa Komisar Hilmi Çausholli, sepse Miçua u caktua Komisar në një brigadë shqiptare në Maqedoni. Në këto ditë çlirimi të Kukësit Hajri Hoxha kujtonte ardhjen në Brigadën e XVII të 112 shokëve e shoqeve që kishin shpëtuar nga kampi nazist gjerman i Prishtinës, ku disa prej tyre u rreshtuan në këtë Brigadë, si i paharruari Kin Dushi që arriti të emërohet edhe Komandant Batalioni. Ai ka shkruar dhe botuar në libër vuajtjet dhe pushkatimet e 105 të rinjve shqiptarë në këtë kamp më 23 Tetor 1944. Po ashtu Kini ka vlerësuar trimërinë e

gjithë shokëve që ishin pushkatuar e në mes tyre përmend heroizmin e ish-partizanëve të Batalionit të Dibrës Spiro Velko, Musa Agolli e të rinjve të tjerë dibranë si: Bilal Konxholli, Tasim Shehu, Hamza Shehu.

Pas çlirimit të Atdheut më 29 Nëntor 1944 Brigada e XVIII S, sipas Urdhrit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë NÇ, veproi deri në Mars 1945 për asgjësimin e disa bandave mercenare të mbetura në zonat e Krumës, Mirditës dhe Pukës. Partizanët e saj kanë qëndruar për disa kohë në Fushë-Arrëz. Pas kësaj në udhëtimet Lumë, Dibër, Gollobordë, Librazhd, Gramsh, Përmet, po sipas Urdhrit të Shtabit të Ushtrisë NÇ mbërritën në Gjirokastrë ku më 23 Prill 1945, efektiv i saj u bashkua dhe u rreshtua në një Brigadë me brigadën e 20-të Sulmuese. Gjatë periudhës 2-mujore efektiv i brigadës i shkaktoi dëme të konsiderueshme armikut

Brigada e XVI-të, dy muaj pas krijimit çliroi Fierin



Shtatëdhjetëetë vjet më parë (më 20 gusht 1944), në Therapel të Skraparit u krijua Brigada e XVI Sulmuese partizane. Në përbërje të saj kishte një efektiv prej prej 465 veta. Në këtë efektiv do të ishin Grupi III i SK, Grupi III i Mallakastrës, Grupi i Pare i Kurvelshit dhe Grupi i Myzeqesë. Më shumë se 85% ishin të rinj e të reja me moshë

15-30 vjeç, ku rreth 60 ishin shoqe.

Në ditën e formimit komanda e brigadës përbëhej nga Rrahman Ruçi, komandant, Avdyl Këllezi, komisar, Gjon Gjoni, zv.komandant dhe Myzafer Trebeshina, zv. komisar. Në zbatim të urdhërit të Komandës së Përgjithshme, shtabi i brigades u percakttoi detyrat 3 batalioneve të vepronin sipas vendndodhjes.

Keshtu, natën e 2-3 shtatorit, batalioni i 3-të kreu një aksion kundër depove gjermane në kodrat e Petovës. Po në këto data veproi dhe batalioni që komandohej nga therpelasi Petref Therepeli në rajonin Poshnje-Uji i ftohtë. Detyrë kryesore mbetej spastrimi i zonës së Myzeqesë nga mbeturinat e Ballit Kombëtar. Kjo detyrë u krye në 10 ditëshin e parë të shtatorit duke likujduar 15 baza të reaksionit.

Me veprimet luftarake të brigades u çliruan fshatra e krahina të tëra të zonës së Myzeqesë. Detyra për çlirimin e Fierit iu ngarkua batalionit të 3-të dhe grupit të 3-të të Mallakastrës në një komandë të përbashkët. Me sulme e kundërsulme forcat partizane çliruan Fierin në orën 17 të datës 15 tetor. Mbetej detyre per

shtabin e brigades çlirimi i Lushnjes. Sulmi për çlirimin e saj filloi në mbremjen e 17 tetorit në koordinim me batalionin e 2-te të brigades se 8-te. Partizanet triumfuan në orën 8 të datës 18 tetor.

Pas kesaj date brigada spastroi zonen nga mbeturinat balliste dhe filloi të merre pjesë në rindertimin e shtëpive dhe të ekonomise. Gjatë periudhës 2-mujore efektiv i brigadës i shkaktoi dëme të konsiderueshme armikut. Nxori jashtë luftimit rreth 310 gjermane të vrare, mbi 250 të plagosur, zuri 65 rober, u çarmatosen 170 ballistë. Shkaterroi 9 tanke, 5 autoblinda, 180 automjete, i kapi armikut 400 pushke, 20 mitroloza, 15 topa e mortaja.

Keto fitore i kushtuan efektivit të brigades 56 dëshmore e shume të plagosur. Aq te pameshirshem ishin bishat naziste sa e dogjen trupin e pajete te vajzes fierake, Heroinien e Popullit, Liri Gero.

Në këtë 78-vjetor, mirenjohja jonë shkon te të gjithë ata partizanë e partizane të Brigades së 16-te S që nuk kursyen as jetën e tyre për çlirimin e vendit nga bisha nazifashiste.

LIBRI

Nga monografia e autorit Mete Peçi kushtuar një figure emblematike në kujtesën historike

“BOTA E GUXIMTARËVE - Kapedan Çelo Picari”

• *“O vizitor, mos iu tremb vekjes, bota është e guximtarëve, e atyre që luftojnë për vatan!”*

Maksim VINÇANI


Dy fjalë për autorin:

Mete Peçi ka lindur në Picar-Gjirokastër në 1951. Veprimtaria letrare e tij është e larmishme: Ka botuar: vëllimet poetike “Letër poetike njerëzve” dhe “Puthje në mermer”, vëllimin me skica e tregime “Çiltër”, librin “Rruga e mundimëshme e dhimbjes” me tematikë nga emigracioni, “Porta e shëndruar në kala”, “Përgjakja e thikave”, “Kur të jem i qetë”, “Në detin e gurbetit”, “Vargëzotet”, “Pse u vonuan dallëndyshet”, “Vargje në shtegëtim” dhe monografinë “Bota e Guximtarëve - Kapedan Çelo Picari”, që kemi marrë si bazë kryesore për shkrimin që po i japim lexuesit.

Kryengritjet shqiptare në shekullin e 19-të kundër reformave centralizuese turke, u udhëhoqën nga kapedanët e malësorëve dhe fshatarësisë si Marko Boçari, Çelo Picari, Zyllyftar Poda, Tafil Buzi, Zenel Gjoleka, Rrapo Hekali, Spiro Gjika, Hodo Nivica, Gjikë Thanasi etj.

Një ndër këta kapedanë të fshatarësisë ishte picarioti Çelo Picari, një figurë emblematike që ka lënë gjurmë në kujtesën historike të popullit me luftën e tij heroike kundër forcave osmane. Jo më pak heroike ka qënë dhe lufta e tij kundë fqinjëve grabitqarë në Çastet kur janë rrezikuar trojet e banuara nga popullsia shqiptare, sikundër ka qënë dhe bashkëpunimi me luftëtarë greke në aksione të përbashkëta kundër armikut të përbashkët. Për figurën dhe veprimtarinë e Çelo Picarit kanë shkruar mjaft, por një material më të kompletuar na jep autori Mete Peçi në monografinë “Bota e Guximtarëve, Kapedan Çelo Picari”. Po kush ishte Çelo Picari!? Lindi në vitin 1801 në fshatin Picar i vjetër të Kurveleshit. Emri i feminisë ishte Xhelil Bega, por e thërrisnin Çelo ndërsa mbiemrin Picari e përvetësoi më pastaj, kur u bë i dëgjuar për burrin e tij. Femininë dhe adoleshencën e kaloi në fshat, duke kullotur bagëtitë dhe duke ndihmuar në punët e familjes. Jeta e Çobanit iu impononte djemve të ishin të shkathët, të fortë dhe të durueshëm ndaj vështirësive, por Çelua spikati dhe dalloj mbi të tjerët. Erdhi një kohë kur fshati “nuk e nxinte”. Kështu që përfundoi në shërbim të Pashait të Janinës, Ali Tepelenës, i cili luftëtarët më të afërt i zgjidhte personalisht. Në oborrin e Pashait stërviteshin dhe mjaft trima suljotë, kapedanë të ardhëshëm të Greqisë si Marko Boçari, Odise Andruco, Thanasi Dhjako etj.

Thuaj se në të gjitha lojrat ushtarake dilte i pari fitimtar. Muza popullore do ta ngrinte lart me vargjet: “Marko Boçari suljot, qan e të këput me lot, se me Çelon s’e dil dot, është djallë picarjot.” Kur hordhi të mëdha turke sulmuan Shqipërinë nga toka e nga deti, u smbrapsën nga forcat e Ali Pashës, të drejtuara nga Çelo Picari dhe Veiz Vasiari. Mbas tërheqjes së trupave të Ali Pashait nga Tepelena drejt Janinës, Çelua edhe pse i plagosur, nuk tërhiqet, por mësyn në krye të 300 djemve kurveleshas dhe hyn në Janinë duke i detyruar turqit të tërhiqen. Mbas shembjes së shtetpashallëkut autonom të Ali Tepelenës luftëtarët shqiptarë u larguan për në Greqi, por me aministrinë e shpallur nga u kthyen në shtëpitë e tyre. Otomanët ndërmorën në shqipëri ekspedita ndëshkimore dhe luftëtarët u riorganizuan në mbrojtje të popullsisë. Çelo Picari, Veliko Jaçe, Asllan e Kapllan Kuça, Be-



lul Toto, Halil Frashëri etj. i kthyen forcat në Shqipërinë e Jugut dhe u përplasën me osmanllinjte të cilët pësuan disfatë mbas disfate. Në këto rrethana krerët e luftëtarëve shqiptarë më 7 nëntor 1828 organizojnë një tubim, nga ku do të dilte “Lidhja e fuqishme shqiptare” me kryesi: Zyllyftar Podën, Ismail Vlorën, Çelo Picarin, Shahin Delvinën, Tafil Buzin, Asllan Kucën, Veliko Jaçen. Në kongres, midis të tjerave u vendos të mos i jepen më ushtarë Turqisë, por të mendojnë për pavarësinë e tyre. Porta e Lartë vendosi dënimin me vdekje të krerëve dhe ja doli me dredhi të vrasit Ismail Vlorën e disa të tjerë. Krerët e indinjuar, u hodhën haptas ne kryengritje kundër Perandorisë. Trimi Asllan Kuca, në krye të 6.000 luftëtarëve mori Thesalinë dhe u shpall sundimtar i saj. Sulltani i shqetësuar e shpalli fermanli (jashtë ligjit).

Trimi tjetër Veliko Jaçe me 12.000 luftëtarë mori Janinën dhe izoloi në kështjellë Valiun e ri Emin Pashën. E gjithë Shqipëria e jugut ishte e çliruar në pamundësi për t’i shtypur forcat shqiptare Porta e Lartë, edhe këtë herë, vendosi të përdori dredhinë. Njëpërmjet Mehmet Reshit Pasha deklaroi paqe, dhe me premtime të rreme ftoi krerët për të festuar në Manastir më 9 gusht të v. 1930. Shumë nga krerët e besuan dhe shkuan në Manastir, ku me pretekstin paradës për nder të tyre, i futi në grackë duke i vranë të gjithë. Ata që kundërshtuan, sepse dyshuan dhe nuk shkuan në Manastir, ishin Zyllyftar Poda, Çelo Picari Tafil Buzi, Hodo Nivica, Abdyl Koka, etj. Në të njëjtën kohë, me të njëjtën dredhi, Emin Pasha, djali i Serasqerit Mehmet Reshid Pashai, masakroi të tjerë kapedanë në Janinë. Dhe hakmarrja nuk vonoi. Kundërpërgjigja ishte e rreptë. Çelo Picari me shokë sulmoi, i vuri zjarrin dhe dogji pjesën qendrore të Janinës ku banonin funksionarët e lartë turq dhe ku u vranë shumë besnikë të Emin Pashës. Tradita e luftëtarëve shqiptarë e ka zakon të marrë hakun e shokëve, dhe populli e hodhi në vargje: “...Çelua ynë me mustaqe, mori hak e zbardhi faqet!” Trazirat e vitit 1833, kundër masave shtërnguese, filluan në Tepelenë dhe u përhapën

në gjithë Kurveleshin.. Janina dhe Porta e Lartë u alarmuan dhe nisën një sulm të rreptë, por ata u smbrapsën me sukses nga trupat që drejtonin Çelua me kapedanët e tjerë. Qendra e takimeve të kapedanëve për organizimin e aksioneve u bë Picari. Betejë e vërtetë u zhvillua në zonën rreth fshatrave Goranxi, Kserovata dhe Guvër nga forcat që drejtonte Çelua. Kështu kaloi jeta luftarake e Çelos për mbi 50 vjet. Me beteja, me kurthe e tradhëti nga turqit, por edhe nga grekët, me të cilët herë luftonin midis tyre, herë bashkëpunonin kundër turqve. Çelua pësoi tre internime e burgosje, por ja doli me trimëri e zgjuarsit të mbijetojë. Në një rast, autoritetet otomane duke dashur të zbulojnë influencën e krerëve, i pyesnin se sa veta kishte secili. Mbas tregonin me mburrje se kishin kaq e aq njerëz, iu pritej koka. I vetmi që shpëtoi ishte Çelua i cili duke nuhatur djallëzinë u përgjigj: “Unë në krahinë time nuk kam asnjë influencë, bile as në fshatin tim s’më dëgjon njeri”. Çelua u lirua nga internimi në vitin 1844. Ai e gjeti vendin më keq se sa e kishte lënë.

Otomanët kishin shtuar masat shtënguese për të vënë në zbatim reformat e tanzimatit. Çelua dhe kapedanët e tjerë organizuan një Kuvend të Madh kryengritës me përfaqësues nga Delvina, Mallakastra, Tepelena, Vlora, Berati, Gjirokastra e Çamëria. Në fillim të Qershorit 1847 kryengritësit depërtojnë në Delvinë, zenë rob komandën turke dhe marrin komandën e krahinës. Pak ditë më vonë kapedani Rrapo Hekali zotëron Beratin dhe rrethon kështjellën e tij me një batalion të ushtrisë turke. Pothuaj njëkohësisht, Myzeqeja, Vlora, Tepelena, Gjirokastra, Përmeti, Filati, Paramithja dhe Margariti, ngrihen kundër pushtetit turk. Një trupë e madhe ushtarake nga Kosturi e paisur me artileri dhe një tjetër nga Grevena, lëvizin drejt Gjirokastrës, por ato u shpartalluan nga kryengritësit të cilët mbanin të rrethuar të tjerët në Gjirokastër. Në 15 Gusht 1847 në Picar-Gjirokastër mlidhen në kuvend të gjithë bejlerët dhe agallarët Çamër e Lebër, komandantë dhe përfaqësues të zonave dhe marrin vendim për të krijuar një shtet të lirë e të pavarur nga Perandoria, duke hartuar dhe shkresën përkatëse me 47 vula e 89 firma. Me ofensivën e madhe të nisur nga Porta e Lartë, kryengritja dalë ngadalë. u shua. Çelon dhe luftëtarët të tjerë i internuan përsëri duke i liruar në fund të vitit 1852, me kusht që të mos kthehej në Picar.

Lapidar do të mbetet përgjigja e Çelos, kur valiu i Janinës donte ta ironizonte me fjalët: “Si guxoni të mateni me ushtërinë e panumërt të Perandorisë!” Dhe flakë për flakë, Çelua tha: “Shqiptari numrimin e përdor për bagëtinë, e jo për trimërinë!” Çelua, i dënuar me vdekje nga Porta e Lartë, nuk mund të kthehej në vend-lindje, kështu që 2-3 vitet e fundit i kaloi në Greqi. Nga historiografia greke Çelua është cilësuar “Luftëtar i solidaritetit ballkanik në luftën kundër Turqisë.” Ka mbetur në histori ndihma që ai u dha kryengritësve grekë në Thesali, ku në krye të një numri luftëtarësh shqiptarë mori pjesë në luftat e tyre çlirimtare kundër turqve, sidomos në betejën e famëshme të Makrinicës, ku dhe u plagos. Në kujtim dhe për nderim të tij, me vendim të Këshillit Bashkiak të Volos në vitin 1993, një rrugë e qytetit është emërtuar: “Rruga Kapetan Çelopicari”. Çelua ndërroi jetë në Athinë në v. 1880. Djemtë e tij e varrosën në Janinë. Në pllakën e varrit të tij shkruhet në turqisht: “O vizitor, mos iu tremb vekjes, bota është e guximtarëve, e atyre që luftojnë për vatan!”

LIBRI


“FJALORI ENCIKLOPEDIK USHTARAK SHQIPTAR” ARRITJE E MADHE NË KULTURËN KOMBËTARE



SHPENDI TOPOLLAJ

Pas një pune serioze mbi 35 vjeçare të disa prej kuadrove më të shquara të ushtrisë tonë (nisur qysh me urdhrin e ministrit të mbrojtjes së kohës me Nr. 80 datë 22 prill të viti 1985), shtëpia botuese “Bogdani” në Prishtinë nxori nga shtypi “Fjalorin Enciklopedik Ushtarak Shqiptar”, FEUSH. Është një botim sa lluksoz aq edhe dinjitoz me mbi 1000 faqe, ku janë përfshirë rreth 5.200 zëra enciklopedikë dhe 250 ilustrime shoqëruese. Natyrisht që për kushtet kur u vu kjo detyrë dhe kërkesat për zbatimin e saj në ushtrinë të atyre viteve, kuptohen lehtë masat e marra, si në aspektin organizativ, ashtu dhe atë financiar. Grupet e punës, shumë pjesëtarë të cilave janë larguar nga jeta, të ndarë sipas drejtimeve dhe llojeve të armëve etj. përbëheshin nga kuadrot më të talentuara të asaj ushtrie, me përvojë të madhe, dhe me bagazh të spikatur kulturor e shkencor. Shndërrimi politik që ngjau te ne pas viteve 90 - të, pra ardhja e demokracisë, krijimi i aleancave të reja, si futja në NATO dhe reforma që pasoi në Forcat e Armatosura edhe në pikpamjet e doktrinës ushtarake, u pasuan nga një shpërfillje e gjithçkaje ishte bërë për përfundimin e këtij Fjalori, aq të domosdoshëm si për kuadrot ashtu edhe për të interesuarit e zakonshëm. Nuk ka ushtri moderne që të mos e ketë përhëndetur e përkrahur përpilimin e një Enciklopedie për ushtrinë e vendit të vet, të paktën qysh nga ai i anglezit Xh. Polmen, aty nga mesi i shekullit të XVI - të. Por në Shqipëri, si për shumë drejtime të tjera që kanë të bëjnë aktualisht me kulturën, duket se kjo punë kolosale, u quajt e tepër.

Asnjë ndihmë nuk u dha nga ministria përkatëse, asnjë fjalë inkurajuese nuk u tha dhe asnjë fond nuk u akordua për botimin e tij, veçanërisht kur ai



përfundoi, falë përkushtimit të rrallë të të ndjerit Prof. dr. Hasan Çipuri dhe sidomos këmbënguljes së oficerit të mençur e atdhetar, kolonelit në rezervë, doktorit të shkencave Kudret Mita, i cili edhe pse larg vendit të tij, nuk reshti së grumbulluari, konsultuari e saktësuar gjithçka duhej përfshirë te ky Fjalor. Madje ishte po ai që bëri të mundur këtë botim të kushtueshëm me kontributin e fëmijëve të tij Ardita, Besian dhe djalit të bashkautorit, Adrian Çipuri. Metodologjia e ndjekur për përpilimin e këtij Fjalori është ajo e zakonshme dhe rreshtimi i materialit ndjek rendin alfabetik. Krahas ngjarjeve historiko - luftarake, vendeve ku ato u zhvilluan, shpikjeve dhe përdorimit të armëve dhe municioneve ndër shekuj, nga ato primitive si shigjeta e heshta e deri tek armët e demtimit në masë, taktikave të përdorura, terminologjisë luftarake, shkollave të oficerëve dhe akademisë së mbrojtjes, doktrinave ushtarake, llogjistikës së kohës, alternimit të llojeve të ndryshme të armëve nga ato tokësore e deri tek ato ajrore e detare, hartuesit e Fjalorit, një vend të veçantë i kanë kushtuar atyre ndodhive dhe sidomos personaliteteve që ndër shekuj ka nxjerrë realiteti shqiptar. Ata janë rreth njëmijë të tillë; strategë, mbretër, komandantë të ndryshëm të formacioneve ushtarake, prijësa popullore, heronj e plot të tjerë që kanë luajtur një rol të rëndësishëm për fatet e Atdheut. Kuptohet se vëmendje e posaçme i është

kushtuar disa periudhave që i dhanë lavdi vendit tonë si skënderbejada me në krye legjendarin Gjergj Kastrioti, Koha e Lidhjes së Prizrenit, kryengritjet anti osmane, ajo Nacional - Çlirimtarja kundër pushtuesve nazi - fashistë dhe perfeksionimi i ushtrisë mbi baza moderne pas çlirimit të vendit, lufta e UÇK - së për çlirimin e Kosovës nga shtypja serbe me burra kreshnikë si Adem Jashari me shokë, të cilat nxorrën dhe figura të shquara e udhëheqës ushtarakë të përmasave të mëdha.

Në fjalor janë përfshirë sipas kriterëve të rrepta edhe plot kuadro të larta që drejtuan ushtrinë tonë ndër vitet e luftës së Ftohtë apo edhe pas ndryshimeve që ajo pësoi më pas. Autorët, këto figura të njohura, i kanë parë e përzgjedhur me objektivitet, si atdhetarë dhe jo sipas bindjeve të tyre politike apo krahëve që përfaqsonin. Për ta fjala vjen, nuk ka rëndësi në ishte drejtues formacionesh partizane, apo balliste a legaliste njëri apo tjetri. Diferencimet i bën historia dhe vetë memoria popullore. Për ata, gjeneralët e ushtrisë që u dënuan me pushkatim apo u burgosën e internuan, gjoja si puçistë, kanë qenë të nderuar e të respektuar për gjithësa bënë për drejtimin e modernizimin e ushtrisë dhe përgatitjen e gjithë popullit për mbrojtje. Politika, mjaft ka sjellë përçarje si atëherë, ashtu edhe sot. Prandaj grupi i punës e ka konsideruar detyrë intelektuale dhe atdhetare njëkohësisht, t'i fryjnë borive të mirëkuptimit, unitetit, vëllazërimit e respektit për gjithësecilin personalitet ushtarak të lartë dhe atë që ai bëri në kohën kur jetoi. Por autorët e këtij Fjalori nuk janë ndalur vetëm tek aspekti ushtarak; ata ushtrinë e kanë parë si një instrument me shpirt. Nga gjiri i saj kanë dalë mjaft shkrimtarë, poetë, piktorë, këngëtarë, artistë të skenës, mjekë, inxhinierë, ekonomistë, si dhe sportistë të ndryshëm që me rezultatet e tyre ja kanë rritur lavdinë si ushtrisë ashtu edhe atdheut të tyre. Nga këndvështrimi tjetër, ata kanë treguar anën njerëzore të ushtarakëve tanë. Përfshirja e këtyre mjeshtrave në faqet e këtij Fjalori, ishte e domosdoshme, pasi edhe e bën atë më të larmishëm dhe vërteton se te kuadrot e ushtrisë kulturore kishte zënë një vend të veçantë. Me këtë kulturë ata kur shkuan për studime jashtë shtetit e kryesisht në ish Bashkimin Sovjetik, jo vetëm dolën më të shumtë me rezultate të shkëlqyera, por edhe lanë përshtypje të pashlyera se edhe në një vend të vogël dhe të varfër, kishte kuadro ushtarakë që njihnin shkëlqyeshëm letërsinë, muzikën, pikturën dhe frekuentonin muzeumet, teatrot e koncertet që jepeshin etj. E gjithë kjo ishte dhe meritë e shkollave tona, si fjala vjen, ajo e mesme ushtarake “Skënderbej” me pedagogë të mrekullueshëm, të cilëve u mbetemi të detyruar për mosfutjen në këtë Fjalor, pasi të tilla ishin kërkesat.

Po ashtu, sikurse autorët edhe vetë kërkojnë mirëkuptimin për ndonjë mos përfshirje e cila gjithsesi ka qenë rrjedhojë e vështirësive të kuptueshme dhe të mosnjohjes dhe jo e ndonjë paragjykimi. Për këtë, ata kërkojnë edhe vërtetë e sugjerime nga lexuesit, për të ndrequr sa më shumë në rast ribotimi i cili mund të realizohet kur administrata e ministrisë së Mbrojtjes ta kuptojë se ka dalë në dritë një vepër madhore që jo vetëm shërben si burim informacioni dhe kujtese, por edhe e bën këdo krenar për rrugën luftarake që ka ndjekur ndër shekuj ushtria shqiptare, qoftë kur nuk kishte shtet të mirëfilltë, qoftë kur ajo mori trajtat e një ushtrie të rregullt. Këto vlera të trashëguara nga e kaluara, fare mirë mund të shërbejnë edhe si burim frymëzimi për kuadrot e ushtrisë sot, të cilët kanë kryer arsimimin dhe kualifikimin ushtarak në Perëndim. Ato janë bij, nipër e stërnipër të një populli që kurrë nuk sulmoi kënd, por që sa herë e lypi nevoja e mbrojtjes së vendit, ka ditur të kombinojë me sukses të plotë mençurinë, aftësinë dhe trimërinë në interes të lirisë e pavarësisë.

BEGAJ: E ardhmja e vendit është përgjegjësi e të gjithëve

(Vijon nga faqja 4)

ndikim vendimtar në emancipimin dhe progresin e shoqërisë.

Edukimi është ushqimi i shpirtit, arsimimi është pasqyra ku ne shohim përparimin tonë dhe çelësi i suksesit.

Shqiptarët kanë ditur ti përdorin këto dy elementë për të mirën e tyre, për një familje dhe shoqëri të shëndetshme. Vendi ka nevojë për politika e nisma të guximshme dhe efektive. Politika që rrisin besimin në drejtësi, ekonomi, shëndetësi, edukim dhe arsim, për një të ardhme siç e meritojnë qytetarët, siç e dëshiron rinia me energjinë, meritat dhe talentin e saj, dhe si e ëndërrojnë fëmijët me çiltërsinë e tyre.

Ndaj ne, populli i Shqipërisë, krenarë dhe të vetëdijshëm për historinë tonë: me përgjegjësi për të ardhmen, me besim te Zoti, me vendosmërinë për të ndërtuar një shtet të së drejtës, demokratik e social, me frymën e tolerancës dhe të bashkëjetesës fetare, me zotimin për mbrojtjen e dinjitetit dhe të personalitetit njerëzor, me aspiratën shekullore të popullit shqiptar për identitetin dhe bashkimin kombëtar, me bindjen e thellë se drejtësia, paqja, harmonia dhe bashkëpunimi ndërmjet kombeve janë ndër vlerat më të larta të njerëzimit, të punojmë të gjithë së bashku për atdheun tonë, Shqipërinë.

Zoti bekoftë Shqipërinë dhe Shqiptarët!

*Fjala e plotë e Presidentit Begaj në Presidencë, më 24 korrik 2022

POEZI

Ali Pashë Tepelena në poezinë e Liljana Muçës

KOKA E PRERË NË ANKAND

Ali Pashë Tepelena, bubullima Ali
Sulltanin e drodhe, Turqinë-Perandori
Paqja e zezë, nënshkruar në ferman të zi.
Hije e vdekjes sipër kokës, luani Ali.

Në shesh të Bezistanit mbushur me sehirxhi.
Ti dukesh sikur ulëret: -Pabesi, pabesi!!
Koka më krenare e botës, po rri në tepsi.
Ej, c'kohë e kobshme, mbarsur me tradhëti.

Koka e vetmuar pa asnjë mbeshtetje rri.
Objekt i vështrimeve të qindra e mijërve sy.
Flokëve e mjekër të irnosur si rrugëtimi në histori
Sytë gjysëm të hapur, por jeta asnjë shkëndi

Jeta asnjë shkëndi-Sulltan a ke qetësi?
Gjumi s'të zë, nuk harrohesh as me orgji.
Koka e Aliut u shit, peshuar ne flori.
E bleu Sulejman Dervishi për shqiptari.

E BUKURA VASILIQI

E bukura Vasiliqi
Balli yt si hëna
Me diellin në sy
Lakmuar nga pashallarë
Lakmuar për orgji
E veshur me mëndafsh
Mbuluar me flori.

Në krahë të Aliut
Ali pashait nga Tepelena
Se kalaja merrte frymë
Se ishe edhe ti, atje brenda .

Aliu shkëmb, gurë stralli i fortë
Në shpirt të tij, ti diell i ngrohtë
Vasiliqi , e bukura Vasiliqi!



Hyre në histori për besnikëri
Për bukuri dhe mencuri
Grua e rralle ne Shqiperi.

Me Ali luanin u bëre një
Kishit një shpirt edhe një zë.

THANA VAJA, BURRI I FORTË

Thanas Vaja burre i fortë
Hyn e del nëpër kala
Me Aliun krah për krah
Ali Pasha si bubullimë
Thanas Vaja si oshëtimë

Pushka ngjitur të rri në faqe
Një hije dyshimi të bredh ndër male
Me sulltanin a ka paqe?!
Jo, përcjellin ato male

Në zjarr të luftës shpirt përzhit
Ik ti tutje , në histori ik

BURRI FAMEMADH

Burri famëmadh ,
Ali Pasha ,Ali
Me sa e sa diplomaci u lidhe ti,
për Shqipëri
Me Napoleonin zulmëmadh
I çmendur veç për lavdi
Po ashtu,
edhe me Rusinë cinike,
me buzëqeshje të akullt dhe enigmatike.
Mbreti i Napolit të ftonte në aleancë
Për hirë të një tradite të vjetër
Por ti ia kuptove dredhitë, ia kuptove patjetër
Si udheheqësin e saj të ftonte
kryedinakja Greqi,
me kusht të quheshe Ilia, kurrë më Ali

Cfar sarkazmë e hidhur!
Si nuk të njohën vallë Ali ?!
Ti ishe dhe mbete shqiptari Ali
Aliu me kokë, Aliu pa kokë
Luan Aliu, qe gjunjët ia drodhe
fodulles Evropë.

TI USHTAR I ALIUT

Diku larg në honin e kohës
Ke mbetur ti trimi, i pashait Ali
Ti ushtari qe duket se fshesa te ka fshirë
Ti ushtari me amanetin në buzë i ngrirë...

Nëna ty të kishte dhënë një emër
Ti ushtari që nuk kërkove kurrë lavdi
Se me t'Aliut u rrihte një zemër
Për tokë të t'pareve, për Shqipëri.

